

Majlinda Hala

Violeta Shamku

LIBËR PËR MËSUESIN

EDUKATË MUZIKORE

4

Majlinda Hala

Violeta Shamku

LIBËR PËR MËSUESIN

EDUKATË MUZIKORE

4



Dr. Majlinda Hala

Violeta Shamku

LIBËR PËR MËSUESIN EDUKATË MUZIKORE 4

Për klasën e katërt të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



Prishtinë, 2022

BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTI-t: Prof. Kristina Palokaj Perkola,
Nazlije Cakolli, Mimoza Gjaka Bllacaku
Redaktore: Aida BARO
Korrektor: Arlon LIKO
Paraqitja grafike dhe kopertina: Elidor KRUIJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN:

© Botime Pegi sh.p.k, dega në Kosovë, qershor 2022
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: cel: +355 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355 069 20 267 73; 069 40 106 88;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Hyrje

Kontaktet e para me muzikën, fëmija i krijon që në moshë të hershme, përmes zërit të nënës, në rrethin familjar, më pas edhe përmes edukimit në institucione parashkollore. Fëmijët këndojnë, dëgjojnë muzikë në rrethin ku jetojnë, dëgjojnë zërat, tingujt apo zhurmat në natyrë, onomatopetë e ndryshme ritmike dhe melodike etj. Këto përvoja do të përdoren për edukimin muzikor në klasën e katërt, duke i konkretizuar përjetimet nga jeta e përditshme në lojëra, këngë, ligjërime ritmike, lëvizje etj. Përmes aktiviteteve muzikore, fëmijët përjetojnë gëzim, hare, qetësi, entuziazëm dhe, në këtë mënyrë, muzika ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në pasurimin emocional të tyre, i fisnikëron ata dhe njëkohësisht shërben si shtysë për zhvillimin e dispozitave të ndonjë prej aftësive muzikore për të cilën mund të ketë predispozitë.

Lënda “Edukatë muzikore” për klasën e katërt ka për qëllim që të nxisë nxënësit ta duan muzikën si veprimtari dhe që përmes pjesëmarrjes së tyre aktive në aktivitetet muzikore në klasë, të zhvillojnë më tutje prirjet muzikore (këndim, luajtje në instrumente ose reagim ndaj muzikës dhe krijim muzikor).

Mësimi në shkollë bëhet më tërheqës dhe më i kënaqshëm përmes aktiviteteve të ndryshme artistike, në të cilat ata nxiten që të marrin pjesë. Synimi kryesor në këtë klasë është që nxënësit të nxiten të përjetojnë veprat artistike muzikore (këngë, pjesë instrumentale etj.) dhe të fillojnë të identifikojnë interesimet e tyre për ndonjë nga veprimtaritë apo shkathtësitë artistike (këndim, krijime pamore, ritmizim, lëvizje etj.). Këto aktivitete nxitin zhvillimin emocional, intelektin, imagjinatën, vëmendjen, interesimin për kreativitet etj.

II. Metodologjia dhe format e punës për planifikimin dhe zhvillimin e muzikës

Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga mësimdhënësit në përputhje me kurrikulën. E rëndësishme është që mësimdhënësit të krijojnë një mjedis mësimi, i cili do t’i nxisë dhe do t’i ndihmojë fëmijët për të zbuluar dhe për të zhvilluar aftësitë dhe prirjet e tyre artistike. Te fëmijët e klasës së katërt, sikurse në klasën paraprake, këngët dhe lojërat muzikore janë thelbësore në mësimin e muzikës.

Këngët mësohen sipas veshit (me imitim) dhe mund të fillojë gradualisht paraqitja e notacionit grafik, me të cilin identifikohen lartësitë dhe gjatësitë tingëllore. Tematika e këngëve dhe lojërave duhet të jetë në përshtatje me moshën dhe aftësitë e tyre performuese (ambitusi), vështirësia e tekstit, e ritmit dhe posaçërisht përmbajtja tekstuale me karakter edukativ dhe didaktik. Këngët duhet të jenë të shkurtra, të thjeshta dhe kryesisht të zhanrit të muzikës për fëmijë, por edhe ato popullore e artistike, të thjeshta dhe të përshtatshme për t’u përdorur gjatë orës mësimore.

Përmbajtja tematike mund të korrespondojë me temat që trajtohen nga fushat e tjera mësimore, por edhe me çështjet e ndryshme ndërkurrikulare. Është e nevojshme që përgjatë këndimit të aplikojnë qëndrimin drejt, shqiptimin e saktë të tekstit, me qëllim që të këndohet me intonacionin e duhur. Fëmijët inkurajohen të këndojnë vetëm, por edhe në grup, të krijojnë efekte të veçanta tingujsh (imitimin e zërave të shokëve, të instrumenteve të ndryshme etj.), duke përdorur zërin, shkopinjat, shuplakat ose instrumentet muzikore, duke ndjekur ndryshimet e ritmit etj.

Për edukimin e ndjenjës ritmike të fëmijëve duhet t'u demonstrojmë në formë konkrete dukurinë e ritmit, se si përjetohet dhe me pastaj ta zbatojmë atë në praktikë, si ta zëmë, dukuritë nga natyra dhe mjedisi, p.sh.: të rrahurit e orës tik-tak, imitimi i trenit, rënia e ziles, rrahja e çekanit, rrahja e pulsit të dorës, rrahja e kabanës, rrahja e daulles në një marsh etj. Ligjërimet ritmike shoqërohen me lëvizje ritmike ose fjalë të ndryshme të ndara në rrokje, duke i shoqëruar me duartrokitje, me shkopinj etj. Është e këshillueshme që ushtrimet ritmike të bëhen krahas këngëve dhe lojërave fëmijërore.

Puna me instrumentet muzikore shton interesin për aktivitetet muzikore, si dhe ndihmon shumë në edukimin e ndjenjës ritmike apo melodike. Në këtë mënyrë krijojmë modele të thjeshta ritmike; rrahje me pëllëmbë, me vegla, me goditje etj. Mund të krijojmë instrumente prej materialeve ricikluese, me të cilat shoqërojmë këngët, ligjërimet, apo edhe luajmë ritme e melodi. Në këtë pjesë inkuadrohet edhe të mësuarit për disa nga konceptet bazike muzikore (ritmi, gjatësitë e ndryshme tingëllore, raportet ritëm-metër etj.), shoqëruar edhe me simbolet grafike e të shkrimit muzikor.

Dëgjimi është mënyra kryesore nëpërmjet së cilës fëmija vihet në marrëdhënie me muzikën. Përmes dëgjimit, ai shpreh emocione që sjell kënga, vepra instrumentale etj. Mësuesi/ja duhet të kultivojë ndjenjën e të dëgjuarit të zërit të tij kur fëmija këndon këngën, të shoqërojë muzikën me lëvizje të përshtatshme (duke vallëzuar balet, vals, marsh etj.). Dëgjimi zhvillon njëkohësisht edhe aftësinë për komentimin e pjesëve instrumentale që nxënësit dëgjojnë, me një fjalor të thjeshtë e të përshtatshëm. Mësuesi/ja mund të përdorë metodën e krahasimit, ku krahasohet një valle me një marsh, një ninullë me një muzikë vallëzimi; krahasimi i ngjyrës së zërave të shokëve, të kafshëve, instrumenteve etj. Pjesët që duhet të dëgjojë kjo moshë duhet të jenë të përzgjedhura me kujdes, të jenë të thjeshta në përmbajtje muzikore dhe të zgjasin 2 deri në 4 minuta.

Në aspektin e ndërlidhjes dhe të integritetit, muzika mund të jetë pjesë e çdo teme të realizuar në klasën e tretë nga fusha të ndryshme; p.sh.: në matematikë, krahasimi i thyesave me ndarjen e njësish për numërim (nota katërshe, gjysmë, tetëshe), dukuritë e ndryshme muzikore në shkencat e natyrës (si prodhohet zëri, si përçohet zëri etj.) dhe ushtrimet gjatë orëve të edukatës fizike (ecja, vrap, aktivitetet e ndryshme) mund të shoqërohen me muzikë ritmike. Pra, në çdo temë apo njësi mund të inkuadrohet muzika, përmes dëgjimit ose këndimit, për ta bërë mësimin më tërheqës për fëmijët e kësaj moshe. Muzika mund të jetë edhe mjet i mirë për çlodhje gjatë pushimeve të shkurtra. Muzika e qetë i qetëson nxënësit dhe ndikon që të jenë të përgatitur për mësimin e radhës. Shumë aktivitete rutinë mund të sinjalizohen përmes këngëve të ndryshme ose shembujve të përshtatshëm muzikorë për dëgjim.

Planifikimi i punës mësimore dhe procesi i mësimdhënies është një moment/fazë, e cila kërkon t'u japë njohuritë e duhura nxënësve, të nxitë nevojat e tyre, interesat dhe mënyrat e të mësuarit. Proces i mësimor do të ketë rezultate nëse nxënësit janë të nxitur për të nxënë dhe ku secili prej tyre mëson sipas një mënyre të caktuar apo të njohur në literaturën pedagogjike si *stile të të nxënësve*. Disa nxënës mësojnë përmes *perceptimit*, të tjerë mësojnë duke *analizuar apo reflektuar*, disa përmes *të parit dhe të dëgjuarit*, disa mësojnë vetëm, të tjerë mësojnë në grupe, disa mësojnë në tërësi përmbajtjen mësimore, ndërsa të tjerë e ndajnë atë në pjesë më të vogla logjike.

Krahas këtyre përcaktimeve të të nxënës, janë mësimdhënësit të cilët gjatë përdorimit të strategjive dhe metodave në procesin mësimor, nxjerrin në pah artin dhe mjeshtërinë e tyre, por edhe vënë në zbatim përmes stileve të të nxënës këto metoda.

Mësimdhënësi të caktuar përdorin më shumë demonstrimin, të tjerë ligjërimin, reflektimin, diskutimet, por ka edhe nga ata që përqendrohen më shumë në të menduarit, të kujtesa, në të kuptuarit. Për të arritur suksese në procesin mësimor duhet patjetër që mësimdhënësi t'i zbatojë stilet e të nxënës, duke njohur më parë mënyrat se si mësojnë nxënësit, si pikëmbështetje për planifikimin e punës mësimore, përputhshmërisë së stileve të të nxënës dhe përdorimit të metodave apo teknikave të mësimdhënies në varësi të stileve të përdorura. Stilet e të nxënës, nëpërmjet metodave dhe teknikave të mësimdhënies përmbushin detyra të rëndësishme të mësimdhënies sepse:

- ruajnë *përfshirjen aktive*;
- nxitin *diskutim të hapur*;
- nxitin nxënësit të krijojnë dhe të bëjnë pyetjet e tyre;
- ndihmojnë *shprehjen e mendimeve* të nxënësve;
- ruajnë *motivimin* e nxënësve për të mësuar;
- sigurojnë një mjedis ku *respektohen mendimet*;
- krijojnë një shtresë për *reflektim* në atë që nxënësit *vlerësojnë*;
- shërbejnë si nxitje për *ndryshim*;
- vendosin shpresë për *përfshirjen kritike* të nxënësve;
- ndihmojnë *mendimin kritik* në nivele të larta e të ndërlikuara.

Disa nga stilet e të nxënës që përdoren më shpesh në lëndën “Edukatë muzikore” janë përshkruar më poshtë:

Stili i të nxënës pamor: Kur nxënësi/ja e përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së të parit. Në këtë rast, mësimi konkretizohet, duke përdorur mjete mësimore si: *harta, fotografi, grafikë, piktura, ngjyra, makete, ilustrime, vizatime, DVD (ku kemi dy lloje stilesh: pamore dhe dëgjimore)* etj. Të nxënës përmes të parit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi/ja, ku kërkohet përqendrimi i nxënësve në:

- vëzhgimin e materialeve të vendosura për të memorizuar apo për të kujtuar një personalitet, një ngjarje, një situatë të caktuar në kontekstin e temës mësimore;
- vëzhgimin e materialeve të vendosura për të nxitur diskutimin apo për të verifikuar njohuritë e marra më parë.

Stili i të nxënës dëgjimor: Kur nxënësi/ja e përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së dëgjimit. Këta nxënës përvetësojnë më mirë dhe më lehtë njohuritë nëpërmjet *incizimeve, bisedave, diskutimeve* ku bëhen vlerësime, jepen mendime, përfundime, bëhen analiza etj. Të nxënës përmes dëgjimit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi/ja, ku kërkohet përfshirja e nxënësve në:

- dëgjimin e muzikës apo një situatë në kontekstin e temës mësimore;
- biseda dhe diskutime në grup për prezantimin e punëve të ndryshme;
- veprimtari që kërkon të folur të rrjedhshëm dhe të qartë.

Stili i të nxënësve kinestetik: Kur nxënësi/ja përvetëson përmbajtjet mësimore në mënyrë aktive, duke vepruar, luajtur, shkruar, vizatuar etj. Këta nxënës janë më të suksesshëm nëse:

- e prekin dhe e ndiejnë përmbajtjen mësimore;
- i përdorin pjesët trupore dhe ndjenjat;
- përdorin gjuhën e ndjenjave.

Përmes stileve të të nxënësve, nxënësit zhvillojnë prirje dhe shkathtësi të ndryshme, si: bashkëveprimi në lojëra të ndryshme muzikore apo aktivitete në grup, performime muzikore dhe kërcimore në shfaqjet skenike, kërcim apo teatër, vëzhgime dhe analiza të veprave figurative, biseda dhe debate në lidhje me çështje të caktuara shkencore etj.

Të tria këto stile harmonizohen dhe ndihmojnë çdo mësuesdhënës/e të planifikojë veprimtari të larmishme mësimore, duke përdorur mjaft teknika dhe metoda të mësuesdhënies.

Tematikat dhe përmbajtjet mësimore janë të integruara në funksion të edukimit me muzikën dhe mësimit të muzikës. Realizimi i këtyre përmbajtjeve përmes veprimtarive të ndryshme muzikore ndihmon në njohjen, edukimin dhe kultivimin e nxënësve me vlerat muzikore më të spikatura të kulturës kombëtare shqiptare, por edhe ato botërore. Disa veprimtari muzikore që kanë të bëjnë me procesin e mësimit të muzikës ku ndihmojnë dhe stilet e të nxënësve janë përshkruar më poshtë:

1) *Mësimi i këngëve* bën pjesë në tri stilet e mësuesdhënies: të nxënësve pamor, dëgjimor por edhe kinestetik, sepse këngët duhet:

- të mësohen (*dëgjimor*);
- të këndohen duke respektuar të gjitha kërkesat e këndimit dhe repertorin e sugjeruar për t'u mësuar (*pamor – ndjekja me sy e takeve që jep mësuesin/ja*);
- të shoqërohet edhe me instrumente muzikore popullore, (*kinestetike*) por edhe Orf;
- të shoqërohet me lëvizje trupore (*kinestetike*).

2) Në fushën e lojës me instrumente muzikore, mësuesi/ja bashkëpunon dhe angazhon nxënësit në përdorimin e instrumenteve muzikore popullore shqiptare të ngjashme edhe me instrumentet ORF për shoqërimin e këngëve që këndojnë.

3) *Dëgjimi muzikor* është veprimtari muzikore që bën pjesë në stilin e të nxënësve dëgjimor dhe kinestetik, sepse edukon përqendrimin dhe vëmendjen ndaj dëgjimit të muzikës, por synon edhe memorizimin e njohurive muzikore në përjetimin e muzikës përmes veprave muzikore shqiptare dhe ato botërore.

Metodat dhe teknikat e mësuesdhënies për të përmbushur stilet e të nxënësve në muzikë janë të shumta, dhe u japin mundësinë nxënësve të shfaqin dhe të zhvillojnë potencialin muzikor e artistik që zotërojnë brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimit të muzikës do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata zbulojnë, kuptojnë, krijojnë dhe performojnë muzikën nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike.

Disa teknika shumë efektive në orën e muzikës janë: *Brainstorming, Diagrami i Venit, Loja me role, Kllaster etj.*

III. TEKNIKA TË MËSIMDHËNIES

III.1 Në stilin e të nxënit pamor dhe dëgjimor veçojmë edhe teknikën e Kllasterit. **Kllasteri** ose grupimi i mendimeve që, ndonjëherë, në literaturë emërtohet “harta e mendimeve”, është një teknikë që i nxit nxënësit të mendojnë për të krijuar lidhje midis fakteve. Shërben si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të mësuarit, duke sjellë nga kujtesa njohuritë muzikore që ata kanë dhe duke i plotësuar ato më tej gjatë fazave të tjera të orës mësimore.

III.2 Rrjeti i diskutimit është një teknikë e mësimdhënies, gjatë së cilës bëhet organizimi grafik i informacionit. Kjo teknikë i bën nxënësit të jenë të vëmendshëm ndaj dëgjimit të veprave muzikore, për të kuptuar përmbajtjen muzikore të veprave dhe krahasuar ato. Përdoret në fazën e realizimit të kuptimit dhe të reflektimit. Sipas kësaj teknike, klasa ndahet në dy grupe (“Pro” dhe “Kundër”). Diskutimi midis grupeve vazhdon 15-25’, sipas temës dhe mund të realizohet me nxënës/e të çdo moshe.

III.3 *Brainstorming* është një veprimtari që bën pjesë në **stilin pamor** por edhe dëgjimor, duke iu përshtatur lëndës së muzikës, sepse nëpërmjet vendosjes së një fjale kryesore apo fragmenti muzikor për dëgjim në CD, shërben si fillimi i një diskutimi në mësim për një problem të caktuar, i cili më pas vazhdon me metoda e teknika të tjera.

Qëllimi i përdorimit të *Brainstorming*-ut është të vërë në dukje sa më shumë ide, zgjidhje ose komente për një problem të dhënë. *Brainstorming*-u përdoret për të shprehur ide të reja me të gjithë klasën ose me një grup nxënësish dhe karakterizohet nga një lojë me përmasa të gjera dhe nga një intensitet i të shprehurit të larmishëm për gjëra të njohura.

III.4 Tabela e koncepteve është një teknikë që bën pjesë në **stilin dëgjimor**, një teknikë racionale për të organizuar informacionin muzikor përmes dëgjimit dhe krahasimit të disa veprave muzikore. Përdoret veçanërisht kur jepen njëkohësisht më shumë se një koncept a dukuri. Ndihejmon së tepërmi të kuptuarit, përmes strukturimit të materialit, pas leximit dhe në realizimin e skemave të qarta, që sigurojnë qëndrueshmërinë e dijeve. Kjo teknikë përdoret me sukses në fazën e realizimit të kuptimit dhe reflektimit.




Tabela e koncepteve hartohet duke renditur konceptet apo njohuritë muzikore, që duhet të krahasohen dhe në kolona renditen tiparet apo karakteristikat mbi bazën e të cilave bëhet ky krahasim i veprave muzikore.

TIPARE DALLUESE	TË PËRBASHKËTAT	TIPARE DALLUESE
○ _____	○ _____	○ _____
○ _____	○ _____	○ _____
○ _____	○ _____	○ _____

III.5 Diagrami i Venit është teknikë që bën pjesë në **stilin dëgjimor**, me anë të të cilit evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve muzikore. Diagrami i Venit ndërtohet me prerjen e dy a më shumë rrrathëve. Përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit, pothuajse në çdo orë mësimi. Nëpërmjet tij, nxënësit zbulojnë tipare të përbashkëta dhe veçori dalluese në varësi të specifikave të temës së mësimit, si dhe mbajnë qëndrime personale lidhur me to.



IV. MATERIALE DHE BURIME MËSIMORE

Gjatë mësimit të muzikës për realizimin e kompetencave, mësimmshënësi përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi/ja i prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Ai përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon mjedisin e përshtatshëm për aktivitete. Teknologjia ka një ndikim të madh në muzikë duke ndihmuar nxënësit të eksplorojnë këngë me tematikë të ndryshme, për të rinj, arie, mjuzikëll, vepra muzikore të ndryshme, duke zhvilluar aftësitë e tyre në njohjen më të plotë të muzikës.

Tekstet dhe materialet sigurojnë përmes përdorimit të tyre një qasje të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Me anë të mediave, detyrave dhe projekteve të ndryshme, nxënëse u krijohet mundësia të demonstrojnë apo të prezantojnë punët dhe krijimet e tyre.

Muzika studiohet përmes njohjes dhe përdorimit të mjeteve, materialeve, teknikave e procedurave specifike muzikore, p.sh: për dëgjim muzikor, shikim të shfaqjeve për ndjekjen e pjesëve muzikore, të këngëve përdoren magnetofoni, TV-ja, CD-ja dhe DVD-ja.

Përveç materialeve shfrytëzohen edhe burime mësimore, si: teksti shkollor, interneti etj.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- *Mjetet audiovizive si:* TV, magnetofon, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.
- *Mjetet dëgjimore:* radio, magnetofon etj.
- *Mjetet verbale, tekstet si:* tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, fletoret e punës, katalogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënëseve dhe demonstruar vepra të ndryshme muzikore. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për muzikën. Ky plan është i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre krijuese dhe performuese, si dhe në krijime të ndryshme.
- *Mjedisi mësimor* (klasa, kabinetet e muzikës etj.).

V. KUPTIMI DHE INTERPRETIMI I SIMBOLEVE QË PËRNDJEKIN TEKSTIN E NXËNËSIT: EDUKATË MUZIKORE 4

V.1. Muzikë do të thotë:

- të këndosh;
- të dëgjosh;
- të krijosh;
- të çmosh;
- të vlerësosh;
- të marrësh pjesë në koncerte.

Këto eksperiencë do t'ju ndihmojnë për të çmuar dhe vlerësuar muzikën përreth jush. Por më e rëndësishmja është që ju të kuptoni se rrugët për të krijuar në muzikë dhe për ta kuptuar atë, janë të shumëllojshme. Muzika është një emocion që zhvillohet brenda jush dhe ju performoni me të.

Shpjegimi i simboleve

	Dëgjo këngën dhe veprën muzikore		Ndërto instrumente me goditje.
	Pozicioni dhe rregullat e këndimit		Çmo dhe vlerëso.
	Zbavitem dhe mësoj.		Bashko pikat.
	Mësoj më shumë për tingujt.		Mësoj.

PLANI VJETOR

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE

KLASA: IV

Libër për mësuesin

Lëndët e fushës	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkollës
Lënda: Edukatë muzikore	PERIUDDHA I		PERIUDDHA II		Komunikues efektiv I. 3, 7, 9 Mendimi kreativ II.1, 3, 7 Nxënës i suksesshëm III.2, 4, 5, 9 Kontribues produktiv IV.1, 3 Individ i shëndoshë V.9 Qytetar i përgjegjshëm VI.3, 5
	Shtator-Tetor	Nëntor-Dhjetor	Janar-Shkurt-Mars	Prill-Maj-Qershor	
	9 orë	8 orë	11 orë	9 orë	
	Këngë (3 orë)	Këngë (1 orë)	Këngë (3 orë)	Këngë (4 orë)	
		Krijime ritmike (1 orë)	Krijime ritmike (1 orë)	Krijime ritmike (1 orë)	
	Lojërat muzikore/rituale (1 orë)	Lojërat muzikore/rituale (1 orë)			
	Elemente bazike të gjuhës artistike (4 orë)	Elemente bazike të gjuhës artistike (3 orë)	Elemente bazike të gjuhës artistike (1 orë)		
		Llojet e muzikës (1 orë)	Llojet e muzikës (1 orë)		
		Instrumentet muzikore (1 orë)	Instrumentet muzikore (2 orë)		
	Krijues dhe performues (1 orë)	-	Krijues dhe performues (1 orë)		
				Ngjarje artistike (1 orë)	Individ i shëndoshë V.9 Qytetar i përgjegjshëm VI.3, 5
				Çmuarje dhe vlersim (1 orë)	
			Planifikime të lira (2 orë)	Planifikime të lira (2 orë)	

Temat mësimore përgjatë vitit shkollor	
1: Zilja e shkollës	
2: Tingulli dhe burimet e tij	
3: Nota dhe pushimi	
4: Ritmi dhe muzika	
5: Himni i flamurit	
6: Ritmi me dy dhe tri goditje, takti muzikor	
7: Ritmi me katër goditje	
8: Identifikojmë artistët tanë	
9: Xhaxhi, këngën ma mëso!	
10: Notat muzikore Sol, Mi, Do	
11: Notat muzikore Re, Fa, La, Si	
12: Plotësimi muzikore	
13: Dëgjoj muzikë	
14: Shenjat e ngjyrit	
15: Të falim dashuri	
16: Vallëzimet sipas ritmit	
17: Ndërtojmë instrumente muzikore ORF	
18: Muzikantë të shquar shqiptarë	
19: Kënga një- dy- dhe tri pjesëshe	
20: Dua të gëzoj	
21: Instrumentet e muzikës popullore	
22: Kompozitorë të njohur	

Temat mësimore përgjatë vitit shkollor	
	23: Një, dy, tre, sonte erdhëm ne 24: Ngjyros instrumentin muzikor 25: Muzika dhe artet e tjera 26: E dua kitarën 27: Tastiera 28: Krijojmë dhe këndojmë 29: Kënga ime 30: Ngjarje artistike 31: Lamtumirë 32: Një botë me mirësi 33: Festa e këngës 34: Çmuarje dhe vlerësim

PERIUDHA I

MUAJT: SHTATOR–TETOR/NËNTOR–DHJETOR

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE

LËNDA MËSIMORE: EDUKATË MUZIKORE

KLASA: IV

TEMA MËSIMORE: KËNGË, LOJËRAT MUZIKORE DHE KRIJIMET MUZIKORE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.

Nxënës i suksesshëm:

III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës/lojë.

Kontribues produktiv:

IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.

Individ i shëndoshë:

V.2 Dëshmim i vetëbesimit.

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.5 Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për shoqërinë dhe për mjedisin.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës, që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I.1.1 Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit.

I.1.5 Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.

I.1.2 Ritmizon vargje, ritme (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë).

2.1 Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik njih (vëren) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse, p.sh.: vëren dhe dallon tingullin, vijat, ngjyrën, ritmin, melodinë, formën, dimensionin, raportin, kontrastin, teksturën etj.

4.1 Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.

4.2 Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetjake dhe të të tjerëve me fjalor shumë të thjeshtë.

TEMA MËSIMORE: ELEMENTET BAZIKE TË GJUHËS ARTISTIKE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës, që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.7 Dhënia dhe pranimi i informacionit muzikor për tingujt në mënyrë konstruktive.

Nxënës i suksesshëm:

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

Kontribuues produktiv:

IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.5 Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për shoqërinë dhe për mjedisin.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës, që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

2.1 Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik njeh (vëren) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse, p.sh.: vëren dhe dallon tingullin, vijat, ngjyrën, ritmin, melodinë, formën, dimensionin, raportin, kontrastin, teksturën etj.

TEMA MËSIMORE: KRIJUES DHE PERFORMUES

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës, që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës, që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

3.1 Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve (p.sh.: muzikën vokale, instrumentale, portretin, peizazhin etj.).

4.1 Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.

4.2 Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetjake dhe të të tjerëve me fjalor shumë të thjeshtë.

PERIUDHA I								
MUAJTI: SHTATOR–TETOR (9 orë) / NËNTOR–DHJETOR (8 orë)								
Temat mësimore	Rezultatet e të nxëniet për tema mësimore	Temat mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet	
Këngë	Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimit instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësimdhënësit/es dhe në mënyrë kreative. Luan lojëra të thjeshta muzikore, të shoqëruara me këngë, të cilat kanë gjuhën shprehëse të përshtatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjella me lëvizje trupore e me vegla muzikore fëmijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, si dhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodija, vetitë e tingullit muzikor etj.). Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).	Zilja e shkollës	4 orë	Bisedë	Buletini i pjesëmarrjes	Njeriu dhe natyra	Teksti shkollor Softuerë arsimorë CD DVD	
		Himni Flamurit		Diskutim				Gjuhë shqipe
		Xhaxhi, këngën ma mëso!		Lojë me role	Portofoli i nxënësit			Edukatë muzikore
		Të falim dashuri		Brainstorming				Edukata fizike, sporte dhe shëndeti
				Diagrami i Venit	Vlerësim i ndërsjellë			Shoqëria dhe mjedisi
Lojëra muzikore		Ritmi dhe muzika		Punë në grupe		Gjuhë angleze	Matematikë Çështjet ndërkurrikulare Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë Globalizimi dhe ndërvlerësia Edukimi për media	
		Vallëzojmë sipas ritmit	2 orë	Punë individuale				

PERIUDHA I							
MUAJTI: SHTATOR–TETOR (9 orë) / NËNTOR–DHJETOR (8 orë)							
Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Temat mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Elementet bazike të gjuhës artistike	- Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë - Njëh bazat notacionit muzikor (vlerat dhe lartësitë tingëllor) - Identifikon dukuritë muzikore ritmike e melodike në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjuara - Përjeton dhe dallon dy dhe tre pjeshmërinë në këngët e kënduara	Tingulli dhe burimet e tij	7 orë	Bisedë	Buletini i pjesëmarrjes	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti	Teksti shkollor Softuerë arsimorë
		Ritmi me dy dhe tri goditje, takti muzikor		Diskutim			
		Nota dhe pushimi	Lojë me role	Portofoli i nxënësit	Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë	Teksti shkollor Softuerë arsimorë	
		Ritmi me katër goditje	Brainstorming	Vlerësim i ndërsjellë			
		Notat muzikore SOL, MI, DO	Diagrami i Venit				
Notat muzikore RE, FA, LA, SI	Punë në grupe					Çështjet ndërkurrikulare Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë Globalizimi dhe ndërvlerësia Edukimi për media	CD DVD
Shenjat e ngjyrit				Punë individuale			

PERIUDDHA I						
MUAJT: SHTATOR–TETOR (9 orë) / NËNTOR–DHJETOR (8 orë)						
Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Temat mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare
Krijim muzikor	Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike.	Plotësime muzikore	1 orë	Bisedë	Buletini i pjesëmarrjes	Njeriu dhe natyra
	Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëgjëzat etj.			Diskutim		Gjuhë shqipe
	Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-përgjigje muzikore etj.).			Lojë me role	Portofoli i nxënësit	Edukatë figurative
	Këndon ose luan në instrumente fëmijërore ndonjë krijim origjinal të shkurtër (ritmik, melodik) me inkurajimin dhe ndihmën e mësimdhënësit/es.			<i>Breinstorming</i>	Vlerësim i ndërsjellë	Edukatë muzikore
				Diagrami i Venit		Edukata fizike, sporte dhe shëndeti
				Punë në grupe		Shoqëria dhe mjedisi
				Punë individuale		Gjuhë angleze
						Matematikë
						Çështjet ndërkurrikulare
						Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike
						Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm
						Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë
						Globalizimi dhe ndërvlerësimi
						Edukimi për media
						Teksti shkollor
						Softuerë arsimorë
						CD
						DVD

PERIUDHA I							
MUAJTI: SHTATOR–TETOR (9 orë) / NËNTOR–DHJETOR (8 orë)							
Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Temat mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Krijues dhe performues	• Emërton disa (së paku 4 krijues, interpret të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale e kombëtare muzikore. • Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistike botërore dhe lokale	Identifikojmë artistët tanë	2 orë	Bisedë Diskutim	Buletini i pjesëmarrjes	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore	Teksti shkollor Softuerë arsimorë
		Dëgjoj muzikë		Lojë me role Brainstorming Diagrami i Venit Punë në grupe Punë individuale	Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë Çështjet ndërkurrikulare Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë Globalizimi dhe ndërvlerësia Edukimi për media	CD DVD

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Instrumentet muzikore	Dallon ngjyrën tingëllore të instrumenteve muzikore (popullore dhe klasike) përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshtatshme për moshën e tyre Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizuelisht Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale recikluarë dhe organike (marakas me oriz, miser, dajre te vogla etj)	Ndërtojmë instrumente muzikore ORF	1 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Brainstorming Diagrami i Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë Çështjet ndërkurrikulare Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë Globalizimi dhe ndërvarësia Edukimi për media	Teksti shkollor Softuerë arsimorë CD DVD

PERIUDHA II

MUAJT: JANAR-SHKURT-MARS

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE

LËNDA MËSIMORE: EDUKATË MUZIKORE

KLASA: IV

TEMA MËSIMORE: KËNGË DHE KRIJIMET MUZIKORE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.

Nxënës i suksesshëm:

III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës-lojë.

Kontribuues produktiv:

IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.

Individ i shëndoshë:

V.2 Dëshmim i vetëbesimit.

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.5 Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I.1.1 Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit.

I.1.5 Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.

I.1.2 Ritmizon vargje, ritme (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë).

2.1 Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik njih (vëren) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse, p.sh.: vëren dhe dallon tingullin, vijat, ngjyrën, ritmin, melodinë, formën, dimensionin, raportin, kontrastin, teksturën etj..

4.1 Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vërtetimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.

4.2 Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve me fjalor shumë të thjeshtë.

TEMA MËSIMORE: ELEMENTET BAZIKE TË GJUHËS ARTISTIKE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës, që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.7 Dhënia dhe pranimit i informacionin muzikor për tingujt në mënyrë konstruktive.

Nxënës i suksesshëm:

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

Kontribuues produktiv:

IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.5 Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

2.1 Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik njih (vëren) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse, p.sh.: vëren dhe dallon tingullin, vijat, ngjyrën, ritmin, melodinë, formën, dimensionin, raportin, kontrastin, teksturën etj.

TEMA MËSIMORE: LLOJET E MUZIKËS, INSTRUMENTET MUZIKORE, KRIJUES DHE PERFORMUES

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

3.1 Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve (p.sh. muzikën vokale, instrumentale, portretin, peizazhin etj.).

4.1 Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vërtetimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.

4.2 Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve me fjalor shumë të thjeshtë.

PERIUDHA II							
MUAJT: JANAR-SHKURT-MARS							
Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Këngë	Këndon dhe interpret on në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik(grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimit instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj).	Dua të gëzoj	3 orë	Bisedë	Buletini i pjesëmarrjes	Njeriu dhe natyra	Teksti shkollos
	Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësimdhënësit/es dhe në mënyrë kreative.	Një, dy, tre, sonte erdhëm ne		Diskutim	Lojë me role	Portofoli i nxënësit	Edukatë figurative
		E dua kitarën		<i>Brainstorming</i>	Vlerësim i ndërsjellë	Edukata fizike, sporte dhe shëndeti	CD
				Diagrami i Venit		Shoqëria dhe mjedisi	DVD
				Punë në grupe		Gjuhë angleze	
				Punë individuale		Matematikë	
						Çështjet ndërkurrikulare	
						Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike	
						Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	
						Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë	
						Globalizimi dhe ndërvarësia	
						Edukimi për media	

PERIUDHA II							
MUAJT: JANAR-SHKURT-MARS							
Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Krijim muzikor	Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike. Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëgjëzat etj. Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-përgjigje muzikore etj.). Këndon ose luan në instrumente fëmijërore ndonjë krijim origjinal të shkurtër (ritmik, melodik) me inkurajimin dhe ndihmën e mësimdhënësit.	Ngjyros instrumentin muzikor	1 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role <i>Brainstorming</i> Diagrami i Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë Çështjet ndërkurrikulare Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm Zhvillimi personal dhe shkathhtëritë për jetë Globalizimi dhe ndërvarësia Edukimi për media	Teksti shkollor Softuerë arsimorë CD DVD

PERIUDHA II							
MUAJTI: JANAR-SHKURT-MARS							
Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Llojet e muzikës	Përjeton dhe dallon dy dhe trepjeshmërinë në këngët e kënduara. Krijon melodi të thjeshta (me zë dhe instrumente muzikore) në formën 2 dhe 3 pjesore të këngës.	Kënga një-, dy- dhe trepjeshë	1 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Brainstorming Diagrami i Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli inxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë Çështjet ndërkurrikulare Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë Globalizimi dhe ndërvarësia Edukimi për media	Teksti shkollor Softuerë arsimorë CD DVD

PERIUDHA II							
MUAJTI: JANAR-SHKURT-MARS							
Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Instrumentet muzikore	• Dallon ngjyrtën tingëllore të instrumenteve muzikore (popullore dhe klasike) përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshatshme për moshën e tyre • Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizuelisht • Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale recikluuese dhe organike (marakas me oriz, miser, dajre te vogla etj)	Instrumentet e muzikës popullore <					

PERIUDHA II							
MUAJTI: JANAR-SHKURT-MARS							
Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Krijues dhe performues	Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistike botërore dhe lokale	Muzikantë të shquar shqiptarë Kompozitorë të njohur	2 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role <i>Brainstorming</i> Diagrami i Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë Çështjet ndërkurrikulare Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm Zhvillimi personal dhe shkathërsitë për jetë Globalizimi dhe ndërvarësia Edukimi për media	Teksti shkollor Softuerë arsimorë CD DVD

PERIUDHA III

MUAJT: PRILL- MAJ-QERSHOR

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE

LËNDA MËSIMORE: EDUKATË MUZIKORE

KLASA: IV

TEMA MËSIMORE: KËNGË DHE KRIJIMET MUZIKORE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.

Nxënës i suksesshëm:

III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës/lojë.

Kontribues produktiv:

IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.

Individ i shëndoshë:

V.2 Dëshmim i vetëbesimit.

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.5 Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I.1.1 Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit.

I.1.5 Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.

I.1.2 Ritmizon vargje, ritme (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë).

2.1 Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, njeh (vëren) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse, p.sh.: vëren dhe dallon tingullin, vijat, ngjyrën, ritmin, melodinë, formën, dimensionin, raportin, kontrastin, teksturën etj.

4.1 Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.

4.2 Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve me fjalor shumë të thjeshtë.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës, që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

2.1 Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik njeh (vëren) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse, p.sh.: vëren dhe dallon tingullin, vijat, ngjyrën, ritmin, melodinë, formën, dimensionin, raportin, kontrastin, teksturën etj.

TEMA MËSIMORE: NGJARJE ARTISTIKE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.

Mendimtar kreativ dhe kritik

II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

4.1 Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.

PERIUDHA III MUAJT: PRILL- MAJ-QERSHOR						
Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temë mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare
Burimet						
Këngë	Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik(grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë simbas instruksioneve të mësidhënësve dhe në mënyrë kreative.	Kënga ime Lamtumirë! Një botë me mirësi Festa e këngës	4 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Brainstorming Diagrami i Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësve Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë Çështjet ndërkurrikulare Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë Globalizimi dhe ndërvlerësia Edukimi për media
						Teksti shkollor Softuerë arsimorë CD DVD

PERIUDHA III MUAJT: PRILL- MAJ-QERSHOR						
Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temë mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare
Krijim muzikor	Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike. Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëgjëzat etj. Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-përgjigje muzikore etj.). Këndon ose luan në instrumente fëmijërore ndonjë krijim origjinal të shkurtër (ritmik, melodik) me inkurajimin dhe ndihmën e mësimeve/ës.	Krijojmë dhe këndojmë	1 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Brainstorming Diagrami i Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë Çështjet ndërkurrikulare Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm Zhvillimi personal dhe shkathhtësi për jetë Globalizimi dhe ndërvlerësia Edukimi për media
						Burimet Teksti shkollos Softuerë arsimorë CD DVD

PERIUDHA III MUAJT: PRILL- MAJ-QERSHOR							
Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temë mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Instrumentet muzikore	- Dallon ngjyrën tingëllore të instrumenteve muzikore (popullore dhe klasike) përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshtatshme për moshën e tyre - Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht - Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale recikluuese dhe organike (marakas me oriz, miser, dajre te vogla etj) Dallon instrumentet per nga materiali ndertues, burimi tingellor (instrumentet te drunjeta, te tunxhit, frymore me harqe etj) , menyra e interpretimit, ansambleeve qe u perkasin etj.	Tastiera	1 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role <i>Brainstorming</i> Diagrami i Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë Çështjet ndërkurrikulare Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë Globalizimi dhe ndërvlerësia Edukimi për media	Teksti shkollos Softuerë arsimorë CD DVD
Çmuarje dhe vlerësim estetiko-artistik		Ngjarje artistike Çmuarje dhe vlerësim	2 orë				

PLANIFIKIME DITORE TË LËNDËS: EDUKATË MUZIKORE 4

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik(grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë simbas instruksioneve të mësidhënësit dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. II. 3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III. 5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 1. Nxënësi/ja merr pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kënga “Zilja e shkollës”			
Fjalët kyçe: teksti i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - këndon këngën në ritëm dhe intonacion; - përjeton tekstin dhe muzikën e këngës, duke interpretuar me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve “klasa”, “shok/shoqe”, “respekt”.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit, duke u kërkuar të përshkruajnë: *shkollën e tyre, klasën, mësuesit, nxënësit* që ata shikojnë dhe dëgjojnë në shkollë.

I diskutojnë ato me njëri-tjetrin.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “*Zilja e shkollës*”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënës. Kujtohen rregullat e këndimit.


Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD;
- procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- demonstrimi i këngës nga mësimezhënësi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD – me vesh nga nxënësit;
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutrale;
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagrar;
- përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i pjesëve të ndryshme të këngës*;
- përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë dhe dinamik, shoqërimi instrumental*.

I
Tring e tring e tring,
zilja po na th’rret,
lamtumir’ pushime,
shkolla po na pret.

Refreni
Me lule n’duar,
m’suesen e rrethojm’,
të gjith’ të gëzuar
klasën po shikojm’.

II
Tring e tring e tring,
zilja po na th’rret,
lamtumir’ pushime,
shkolla po na pret.



Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përvetësuar herë herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të përvetësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)

Nxënësit:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth shkollës së tyre, shokëve që kanë në klasë dhe mësuesit/es së tyre;
- u shpjegojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

Vlerësimi i nxënësit:

Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:

N2: këndimin e këngës me të tjerët;

N3: interpretimin e këngës, me ndjenje dhe emocion;

N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj. Udhëzohen nxënësit për **vizatimin** e shkollës së tyre.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik Tema: Elementet bazike muzikore		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë Njeh bazat notacionit muzikor (vlerat dhe lartësite tingëllor). Identifikon dukuritë muzikore ritmike e melodike në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjuara Përjeton dhe dallon dy dhe tre pjeshmërinë në këngët e kënduara.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 7 Dhënia dhe pranimi i informacionin muzikor për tingujt në mënyrë konstruktive. III. 4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. IV. 3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore. VI. 5 Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Tingulli dhe burimet e tij

Fjalët kyçe: tingull, zhurma, dridhje, tingull natyror, tingull muzikor, tingull vokal.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- evidenton llojet e tingujve në ushtrimet që zhvillon në klasë;
- demonstroi nëpërmjet ushtrimeve cilësi të ndryshme të tingullit;
- krijon shembuj të thjeshtë nëpërmjet llojeve të tingullit;
- ndan përvojën e vet me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Çështjet ndërkurrikulare: Mjedisi

Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme të tingujve në mjedisin përreth dhe muzikë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (5 minuta)

Mësimi fillon me një demonstrim ku nxënësit krijojnë tinguj të ndryshëm nëpërmjet objekteve që disponojnë.

Më pas, thonë çfarë tingulli u krijua.



Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Mësimdhënësi shpjegon se si krijohet tingulli, duke sjellë shembuj të ndryshëm. Mësuesi/ja nxit që ata të shpjegojnë dhe përshkruajnë llojet e tingujve që dëgjojnë në klasë apo mjedisin përreth.

Punë individuale

Çdo nxënës plotëson vendet bosh poshtë çdo figure, duke përcaktuar llojin e tingullit.















Ata diskutojnë me njëri-tjetrin rreth përcaktimeve të tingujve.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)

Mësuesi/ja bën përsëritjen e njohurive të marra përmes një diagrame veni.



Plotësimet e nxënësit/es ruhen në dosjen e tij/saj.

Vlerësimi i nxënësit:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: evidentimin e llojeve të tingujve në ushtrimet që zhvillon në klasë;

N3: demonstrimin nëpërmjet ushtrimeve, cilësi të ndryshme të tingullit;

N4: krijimin e shembujve të thjeshtë nëpërmjet llojeve të tingullit.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për përfundimin e krijimit, duke i udhëzuar ata.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike		Rezultati i të nxëniet të temës: Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. Njeh bazat notacionit muzikor (vlerat dhe lartësitë tingellor).	

Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

III. 2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxëniet.


III. 4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**RNF2.** Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike.**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore:** Nota dhe pushimi**Fjalët kyçe:** nota $\frac{1}{4}$ si njësi numërimi, pushimi $\frac{1}{4}$.**Rezultati/et e të nxëniet për orën mësimore****Nxënësi/ja:**

- identifikon notën $\frac{1}{4}$ si njësi numërimi në muzikë;
- lexon ritmin $\frac{2}{4}$ me nota dhe pushime $\frac{1}{4}$;
- lexon ritmin $\frac{3}{4}$ me nota dhe pushime $\frac{1}{4}$;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:****Fusha:** Matematika

Përdorimi i njohurive matematikore lidhur me njësinë e numrave.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet veprimtarie **argëtuese dhe krijuese**, nxënësit zhvillojnë lojën e tortës. Ata e ndajnë tortën në 8 pjesë, duke u mbështetur edhe në njohuritë matematikore.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Mësimi i njohurive të reja fillon duke shpjeguar notën $\frac{1}{4}$ si njësi numërimi për ritmet muzikore $\frac{2}{4}$, $\frac{3}{4}$ dhe $\frac{4}{4}$. Duke iu referuar lojës së tortës, nxënësve iu shpjegohet ngjashmëria e ndarjes së tortës edhe me vlerat e notave muzikore. Secila prej vlerave të notave në tabelë ka edhe pushimin e vet. Ndalemi pak te shkrimi i notës muzikore.

Emërtohen:




Më pas, **shpjegohet dhe demonstrohet** nota $\frac{1}{4}$.

= me një lëvizje dore = një goditje



Vazhdohet me një ushtrim konkret me notën dhe pushimin $\frac{1}{4}$.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore: (10 minuta)**

Përsëritin njohuritë e marra mbi notën $\frac{1}{4}$ dhe pushimin $\frac{1}{4}$, duke demonstruar kuptimin e njohurive të marra përmes përgjigjeve që japin.

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: identifikimin e notës $\frac{1}{4}$ si njësi numërimi në muzikë;

N3: leximin e ritmit $\frac{2}{4}$ me nota dhe pushime $\frac{1}{4}$;

N3: leximin e ritmit $\frac{3}{4}$ me nota dhe pushime $\frac{1}{4}$;

N4: krijimin e ushtrimeve në ritmet e mësuara duke përdorur notën dhe pushimin $\frac{1}{4}$.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të krijojnë ushtrime të tjera me simbole të muzikës.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Lojëra muzikore		Rezultati i të nxënësve të temës: Luan lojëra të thjeshta muzikore të shoqëruara me këngë të cilat kanë gjuhën shprehëse të përshtatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjella me lëvizje trupore, e me vegla muzikore fëmijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor etj.). Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): I. 9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. II. 3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 1. Nxënësi/ja merr pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ritmi dhe muzika			
Fjalët kyçe: teksti i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore Nxënësi/ja: - kupton rregullat e këngës-lojë; - zbaton rregullat e këngës-lojë njëkohësisht me këndimin; - këndon këngën-lojë ritmikiisht dhe melodikiisht; - krijon dhe plotëson modelet ritmike me dy dhe tri goditje.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Edukimi fizik Kuptimi dhe përdorimi i lojërave të ndryshme.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një veprimtarie gjithëpërfshirëse, ku mësuesi/ja iu kërkon nxënësve të ndahen në tri grupe për të realizuar lojën “Ritmi dhe muzika”. Loja muzikore “Ritmi dhe muzika” do të zhvillohet në tri grupe. Kjo lojë përforcon koordinimin e ritmit në grup.			

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me lojën muzikore “Ritmi dhe muzika”, duke u mbështetur në *stilin dëgjimor* dhe *kinestetik* të nxënësve.

Hapat për zhvillimin e lojës**Grupi I:**

Ekzekuton me instrumente me goditje (trekëndësh) ushtrimin muzikor, me tri goditje.

Grupi II:

Ndjek me kujdes goditjet ritmike që kryejnë fëmijët e grupit I, dhe për çdo ritëm që këta ekzekutojnë, kryen këto veprime për shoqërimin e tyre:

Goditja 1 - vendos duart në mes.

Goditja 2 - vendos duart mbi supe.

Grupi III:

Ndjek me kujdes goditjet ritmike që kryejnë fëmijët e grupit I dhe II, dhe për çdo ritëm që ata ekzekutojnë, kryen këto veprime shoqëruese:

Goditja 1 - vendos duart në mes.

Goditja 2 - vendos duart mbi supe.

Goditja 3 - ul duart poshtë.

Vazhdohet më pas me krijime muzikore.

- Vendos tekstin poetik, poshtë notave muzikore Sol-Mi-Do.



Zoog zoog
la - ra man,
a ma jep
një ko - kërr man?

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)

Nxënësist:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth punës dhe këndimit në grup me modelet muzikore të marra nga kënga “*Ne numërojmë*”;
- diskutojnë me shokët ritmin që krijohet nga ligjërimi dhe këndimi;
- shpjegojnë krijimin e vet, duke e ligjëruar atë saktë ritmikisht.

Vlerësimi i nxënësist:

Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:

N2: kuptimin e rregullave të këngës-lojë;

N3: zbatimin e rregullave të këngës-lojë njëkohësisht me këndimin;

N3: këndimin e këngës-lojë ritmikisht dhe melodikisht;

N4: krijimin e modeleve ritmike me dy dhe tri goditje.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësist për **dëgjimin** (disa herë të këngës-lojë) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Rezultati i të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. II. 3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III. 5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 1. Nxënësi/ja merr pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prires individuale.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kënga “Himni flamurit”			
Fjalët kyçe: teksti i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - këndon këngën në ritëm dhe intonacion; - përjeton tekstin dhe muzikën e këngës, duke interpretuar me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi anglisht Përdorimi me lehtësi i gjuhëve të huaja, këndimi i këngëve në muzikë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Mësimi fillon me një veprimtari (<i>Brainstorming</i>) me nxënësit, duke shkruar në dërrasë fjalë të ndryshme në: <i>flamur, mëmëdhe, atëdhe, etj.</i> , dhe duke u kërkuar të thonë kuptimin e këtyre fjalëve. I diskutojnë ato me njëri-tjetrin.			
Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta) Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Himni i flamurit”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit. Kujtohen rregullat e këndimit.			

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD;
- procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD – me vesh nga nxënësit;
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral;
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave;*
- përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)

Nxënësit:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth interpretimit vetëm dhe në grup;
- shpjegojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

- I

Rreth flamurit të përbashkuar
Me një dëshirë me një qëllim,
Të gjithë atij duk' iu betuar
Të lidhim besën për shpëtim.
Prej lufte veç ay largohet
Që është lindur tradhëtor,
Kush është burrë nuk frikohet,
Por vdes, por vdes si një dëshmor!

- II -

Në dorë armët do t'i mbajmë
Të mbrojmë atdhenë më çdo kënd,
Të drejtat tona ne s'i ndajmë,
Këtu armiqet s'kanë vend.
Se Zoti vet e tha me gojë
Që kombe shuhen përmbi dhe,
Po Shqipëria do të rrojë,
Për të, për të luftojmë ne!

- III -

O flamur, flamur, shenjë e shenjtë,
Te ty betohemi këtu,
Për Shqipërinë atdhenë e shtrenjtë,
Për nderë edhe lavdimin e tu.
Trim, burrë quhet dhe nderohet
Atdheut kush iu bë theror;
Për jetë ay do të kujtohet
Mbi dhe, nën dhe si një shenjtor!

Vlerësimi

Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:

N2: këndimin e këngës me të tjerët;


N3: interpretimin e këngës, me ndjenjë dhe emocion;

N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor;

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike		Rezultati i të nxënësve të temës: Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. Njeh bazat notacionit muzikor (vlerat dhe lartësitë tingellor). Identifikon dukuritë muzikore ritmike e melodike në këngët e kënduara dhe në veprat e dëguara.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): III.2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënësve. III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësve njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ritmi me dy dhe tre goditje, takti muzikor			
Fjalët kyçe: ritëm, 2 goditje, 3 goditje, takt muzikor, krijim.			
Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore Nxënësi/ja: - dëgjon dhe zbulon ritme të ndryshme në mjedisin përreth; - identifikon ritmin me dy dhe tri goditje që shikon në një model ritmik; - krijon ushtrime me ritmin me dy goditje dhe tri goditje, duke shkruar atë përmes simboleve; - shpjegon krijimin e vet; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Edukata fizike, sporte dhe shëndet Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme i koncepteve “ecje”, “marsh”.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese, interaktive dhe gjithëpërfshirëse ku mësuesi/ja krijon dy grupe dhe u kërkon që nxënësve të shqiptojnë fjalë me dy dhe tri rrokje , ndërsa grupi tjetër të gjejë dhe të veçojë objekte të ndryshme që dëgjojnë në jetën e përditshme ose mjedisin përreth që prodhojnë ritëm si p.sh.: ecja, zemra, ora, treni, fshirëset e xhamave të makinës, pika e shiut etj., dhe i diskutojnë me njëri-tjetrin sa goditje dëgjojnë.			
			

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Shpjegohet takti muzikor. Ritmi muzikor me dy dhe tri goditje është ritëm i thjeshtë. Ashtu si fjala, edhe muzika ka theks. Edhe te muzika kemi **theks të fortë** dhe **theks të butë**. Të dyja ritmet rrihen ose ndryshe themi kanë taktin muzikor.

Nxiten nxënësit të punojnë në tekstin e tyre ushtrimet sipas kërkesave që ato kanë.

Ata ligjërojnë ritmin me dy dhe tri goditje.

2/4 Sot në shko - llë ne po shkoj - më
1 - 2 1 - 2 1 - 2 1 - 2

2/4 Këng' të re - ja të më - soj - më
1 - 2 1 - 2 1 - 2 1 - 2

3/4 Ç'pa - mje t'bu - kra ka ven - di im,
Ma - le t'lar - ta, o me ble - rim.
Tra - la la, Tra - la la.
Oh sa bu - ku - ri.

Më pas, ata shoqërojnë ushtrimet me shuplaka apo një instrument me goditje.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi ritmin, imitojnë dhe ligjërojnë, duke demonstruar kuptimin e ritmit me dy dhe tri goditje.

U kërkohet nxënësve të përgjigjen rreth asaj që mësuuan duke shpjeguar:

- me sa goditje ishte ushtrimi i parë që ata lexuan ? Po ushtrimi i dytë që ata kënduan? Ku ndryshojnë ato?
- Pse në përdorim taktin muzikor gjatë leximit të ushtrimeve?

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: dëgjimin dhe zbulimin e ritmeve të ndryshme në mjedisin përreth;


N3: zbatimin e ritmit me dy dhe tri goditje në një model ritmik;

N4: krijimin e ushtrimeve me ritmin me dy goditje dhe tri goditje, duke shkruar atë përmes simboleve;

N4: zotërimin e të gjitha kërkesave muzikore të mësipërme.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të krijojnë modele të tjera ritmike me dy goditje.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike		Rezultati i të nxënësve të temës: Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. Njeh bazat notacionit muzikor (vlerat dhe lartësitë tingellor). Identifikon dukuritë muzikore ritmike e melodike në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjuara.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): III.2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënësve. III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ritmi me 4 goditje, takti muzikor			
Fjalët kyçe: Ritëm, ritmi me 4 goditje, takt muzikor, krijim.			
Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore Nxënësi/ja: - rikujton ritmin me dy dhe tri goditje; - identifikon ritmin me katër goditje që shikon në një model ritmik; - krijon ushtrime me ritmin me 4 goditje, duke shkruar atë përmes njësisë matëse 1/4; - shpjegon krijimin e vet; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Edukata fizike, sporte dhe shëndet Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme të koncepteve “ecje”, “marsh”.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese, interaktive dhe gjithëpërfshirëse ku mësuesi/ja krijon dy grupe dhe u kërkon që nxënësve të grupit të parë të shqiptojnë fjalë me 4 rrokje, ndërsa grupi i dytë të shoqërojë grupin e parë me shuplaka.			
			

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Shpjegohet takti muzikor. Ritmi muzikor me katër goditje është ritëm i thjeshtë. Ashtu si fjala, edhe muzika ka theks. Edhe te muzika kemi **theks të fortë** dhe **theks të butë**. Ritmi 4/4 rrihet ose ndryshe themi kanë taktin muzikor.

Takti muzikor

goditja e parë - poshtë

goditja e dytë - majtas

goditja e tretë - djathtas

goditja e katërt - lart

Nxiten nxënësit të punojnë në tekstin e tyre ushtrimet sipas kërkesave që ato kanë.

Ata ligjërojnë dhe këndojnë ritmin me katër goditje.

Vazhdohet me ushtrimin e radhës, ku ata lexojnë dhe shoqërojnë ushtrimet me shuplaka apo një instrument me goditje.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi ritmin, imitojnë dhe ligjërojnë duke demonstruar kuptimin e ritmit me katër goditje.

U kërkohej nxënësve të përgjigjen rreth asaj që mësuat, duke shpjeguar:

- Me sa goditje ishte ushtrimi i parë që ata lexuan? Po ushtrimi i dytë që ata kënduan? Ku ndryshojnë ato?
- Pse ne përdorim taktin muzikor gjatë leximit të ushtrimeve?

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: identifikimin e ritmeve me katër goditje që shikon në një model ritmik;

N3: zbatimin e ritmit me dy dhe tri goditje në një model ritmik;

N4: krijimin e ushtrimeve me ritmin me dy goditje dhe tri goditje, duke shkruar atë përmes simboleve;

N4: zotërimin e të gjitha kërkesave muzikore të mësipërme.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të krijojnë modele të tjera ritmike me katër goditje.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Artet dhe shoqëria Tema: Krijues dhe interpretues		Rezultati i të nxënit të temës: Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike. Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëgjëzat etj. Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-përgjigje muzikore etj.). Emërton disa (së paku 4 krijues, interpret të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale e kombëtare muzikore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënit. III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 3. Nxënësi dallon relacionet e ndryshme në mes të arteve dhe shoqërisë.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Identifikojmë artistët tanë			
Fjalët kyçe: ngjyrim, artistë.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - zbulon duke bashkuar pikëzat portretin e muzikantit/ten; - plotëson figurën e muzikantit/es duke shtuar informacionin rreth tyre; plotëson punimin, duke ngjyrosur portretin; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika, klasa 4.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkenca dhe mjedisi - Gjeografia Përdorimi i njohurive lidhur me origjinën e muzikantëve shqiptarë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (15 minuta) Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet lojës , ku mësuesi/ja kërkon që nxënësve të bashkojnë pikëzat për të zbuluar foton e artistit shqiptar (Lorenc Antoni, Musa Piperku, Nexhmije Pagarusha, Rita Ora). Vazhdohet më tej duke folur rreth muzikantëve që janë zbuluar duke sjellë deri në dy informacione për secilin. Vijohet me dy veprimtari të tjera ku nxënësit këndojnë ose plotësojnë mbi modelet e dhëna. (15 minuta) Më pas, vazhdohet me ngjyrosjen e skicave sipas dëshirës. (10 minuta)			
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore: Bashkëbisedim (5 minuta) U kërkohet nxënësve të diskutojnë lidhur me krijimet muzikore.			
Vlerësimi i nxënësve: Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në: N2: zbulimin e krijimit muzikor, duke i plotësuar ato; N2: sjelljen deri në dy informacione për muzikantin; N4: plotësimin e skicimit, duke e ngjyrosur atë.			
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR			
Udhëzohen nxënësit të krijojnë ushtrime të reja në shtëpi.			

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik(grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. II. 3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III. 5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 1. Nxënësi/ja merr pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kënga “Xhaxhi këngën ma mëso”			
Fjalët kyçe: teksti i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - këndon këngën në ritëm dhe intonacion; - përjeton tekstin dhe muzikën e këngës, duke interpretuar me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve “profesionet”, instrumentet muzikore, kënga.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Mësimi fillon me një veprimtari (Brainstorming) me nxënësit, duke shkruar në dërrasë fjalën kompozitor /pianist dhe duke u kërkuar atyre të tregojnë çfarë u vjen në mendje lidhur me këtë fjalë. I diskutojnë ato me njëri-tjetrin.			
Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta) Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Xhaxhi këngën ma mëso”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit. Kujtohen rregullat e këndimit.			

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD;
- procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD – me vesh nga nxënësit;
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral;
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave;*
- përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)

Nxënësit:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth profesionit të muzikantit.
- shpjegojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

Vlerësimi

Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:

N2: këndimin e këngës me të tjerët;

N3: interpretimin e këngës, me ndjenje dhe emocion;

N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

- I -

Do, re, mi, do, re, mi,
xhaxhi ç'bën në piano ti?
Thur një këngë për ju fëmij',
ta këndojmë tok të gjith',
anemban' në fush' e mal,
në koncert, në festival.

Dy
herë

Kori: Dhe në festival.

- II -

Re, mi, do, re, mi, do,
xhaxhi, këngën ma mëso.
Ta këndojmë anemban',
ku punojnë prindrit tan',
ne fëmijët kur këndojm'
duarartët i gëzojm'.

Dy
herë

- III -

Mi, do, re, mi, do, re,
notat thurin këng' të re,
krah' merr kjo kënga jon',
porsi zogu fluturon.
Jeta jon' është pranver',
ndaj këndojmë ne përher'.

Dy
herë

Kori: Ndaj këndojmë ne
përher'.


ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike		Rezultati i të nxënës të temës: Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodija dhe harmonia (dur-mol) ne këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. Njeh bazat notacionit muzikor (vlerat dhe lartësitë tingellor)	
Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III. 2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënës. III. 4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Notat Sol, Mi, Do			
Fjalët kyçe: notat muzikore, Sol, Mi, Do.			
Rezultati/et e të nxënës për orën mësimore Nxënësi/ja: - identifikon notat muzikore: Sol, Mi, Do; - ushtrohet duke shkruar notat muzikore Sol, Mi, Do; - lexon notat muzikore Sol, Mi, Do; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Edukata figurative Përdorimi i njohurive gjuhësore për format gjeometrike (rrumbullaku) për të shkruar notat muzikore: Sol, Mi, Do.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet veprimtarie **argëtuese dhe krijuese në grupe**, ku njëri grup lexon vjershën e shkurtër për notat muzikore Sol, Mi, Do dhe grupi tjetër shkruan fjalë që fillojnë pikërisht me rrokjen e parë të këtyre notave.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Mësimi i njohurive të reja fillon duke shpjeguar notat muzikore Sol, Mi, Do, vendin që ato kanë në pentagram dhe si ato emërtohen.

**Veprimtaritë e radhës:**

1. Nxënësit fillojnë të ushtrohen lidhur me shkrimin e notave Sol, Mi, Do.
2. Nxënësit gjejnë emrin e notës dhe e shkruajnë atë poshtë çdo note në kutinë bosh.
3. Nxënësit shkruajnë notën në pentagram sipas emrit të dhënë.
4. Nxënësit këndojnë ushtrimin me nota dhe me fjalë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore: (10 minuta)**

Përsëritin njohuritë që kanë marrë për notat dhe vlerat e tyre, duke demonstruar kuptimin e këtyre njohurive përmes përgjigjeve që japin.

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: identifikimin e notave muzikore Sol, Mi, Do;

N3: shkrimin e notave muzikore Sol, Mi, Do;

N4: leximin dhe këndimin e notave muzikore Sol, Mi, Do.

N4: zotërimin e të gjitha kërkesave muzikore të mësipërme.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të krijojnë ushtrime të tjera me simbole muzikore.


Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që bëjnë nxënësit, duke i lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike		Rezultati i të nxënësve të temës: Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. Njeh bazat notacionit muzikor (vlerat dhe lartësitë tingellor). Identifikon dukuritë muzikore ritmike e melodike në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjuara.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): III. 2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënësve. III. 4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Notat Fa-Re-La-Si			
Fjalët kyçe: notat muzikore, Fa-Re-La-Si.			
Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore Nxënësi/ja: - identifikon notat muzikore <i>fa-re-la-si</i>; - ushtrohet duke shkruar notat muzikore <i>fa-re-la-si</i>; - lexon notat muzikore <i>fa-re-la-si</i>; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Edukata figurative Përdorimi i njohurive gjuhësore për format gjeometrike (rrumbullaku) për të shkruar notat muzikore <i>fa-re-la-si</i> .			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet veprimtarie argëtuese dhe krijuese në grupe , ku njëri grup lexon vjershën e shkurtër për notat muzikore <i>fa-re-la-si</i> dhe grupi tjetër shkruan fjalë që fillojnë pikërisht me rrokjen e parë të këtyre notave .			


Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Mësimi i njohurive të reja fillon duke shpjeguar notat muzikore *fa-re-la-si*, vendin që ato kanë në pentagram dhe si ato emërtohen.



Veprimtaritë e radhës:

1. Nxënësit fillojnë të ushtrohen lidhur me shkrimin e notave *fa-re-la-si*.
2. Nxënësit gjejnë emrin e notës dhe e shkruajnë atë poshtë çdo note në kutinë bosh.
3. Nxënësit shkruajnë notën në pentagram sipas emrit të dhënë.
4. Nxënësit këndojnë ushtrimin me nota dhe me fjalë.



Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi notat dhe vlerat e tyre, duke demonstruar kuptimin e njohurive të marra përmes përgjigjeve që japin.

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: identifikimin e notave muzikore *fa-re-la-si*;

N3: shkrimin e notave muzikore *fa-re-la-si*;

N4: leximin dhe këndimin e notave muzikore *fa-re-la-si*;

N4: zotërimin e të gjitha kërkesave muzikore të mësipërme.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të krijojnë ushtrime të tjera me simbole të muzikës.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Krijimet muzikor		Rezultati i të nxënit të temës: Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike. Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëgjëzat etj. Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-përgjigje muzikore etj.). Këndon ose luan në instrumente fëmijërore ndonjë krijim origjinal të shkurtër (ritmik, melodik) me inkurajimin dhe ndihmën e mësimeve.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

III.2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënit.

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

RNF 1. Nxënësi/ja merr pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Plotësime muzikore

Fjalët kyçe: ritëm, model ritmik, plotësim muzikor.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- ritmizon modele ritmike në ritmin 4/4;
- zhvillon plotësime/lojëra muzikore duke i plotësuar ato;
- krijon krijime të thjeshta muzikore, që t'i përgjigjet ritmit me katër goditje;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkenca dhe mjedisi - Gjeografia

Përdorimi i njohurive lidhur me vendndodhjen e qyteteve të Kosovës.


PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (10 minuta)**

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet **lojës**, ku mësuesi/ja kërkon që nxënësve të lexojnë me zë qytetet dhe notën muzikore që u duhet të dërgojë postieri. Më pas, ata e shkruajnë notën në zarfin e postierin si në qytetin e Prishtinës.




Vazhdohet më tej me dy veprimtari të tjera ku nxënësit këndojnë ose plotësojnë mbi modelet e dhëna. (30 minuta)

Shembulli 1: Kënga plotësohet me nota muzikore sipas fjalëve të tekstit.



Shembulli 2: Ushtrimit i vendoset masa muzikore pas çdo katër notave.



Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore: Bashkëbisedim (5 minuta)

U kërkohet nxënësve të diskutojnë lidhur me krijimet dhe plotësimet muzikore.

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: zhvillimin e plotësimeve/lojërave muzikore duke i plotësuar ato;

N2: ritmizimin e modeleve ritmike në ritmin 4/4;

N4: krijimin e krijimeve të thjeshta muzikore, që t'i përgjigjen ritmit me katër goditje.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të krijojnë ushtrime të reja në shtëpi.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Artet dhe shoqëria Tema: Llojet muzikore		Rezultati i të nxënësve të temës: Dallon lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri përmes dëgjimit muzikor (p.sh muzike për vallëzim, muzike për film, teater, muzike për fëmijë, muzikë për raste të ndryshme, muzikë festive etj.).	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF3. Nxënësi/ja dallon relacionet e ndryshme midis arteve dhe shoqërisë.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Dëgjoj muzikë			
Fjalët kyçe: përjetim emocional, dëgjim muzikor.			
Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore Nxënësi/ja: - identifikon llojin e muzikës gjatë dëgjimit; - përshkruan përjetimin e muzikës së popullore, klasike, moderne sipas emocioneve që ajo i krijon; - shpreh emocionet për muzikën që dëgjon përmes arteve të tjera si: vizatimi, lëvizjet trupore etj.; - respekton mendimin dhe gjykimet e të tjerëve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha Arte: Edukatë figurative Përdorimi i koncepteve figurative në realizimin e emocioneve			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve – Diagrami i Venit (5 minuta) Ora mësimore nis nëpërmjet veprimtarisë muzikore të dëgjimit, me 2-3 fragmente muzikore, duke i nxitur nxënësit të flasin rreth muzikës së tyre të parapëlqyer. Ata dëgjojnë dhe respektojnë me njëri-tjetrin gjatë diskutimeve dhe gjejnë të përbashkëtat dhe të veçantat e fragmenteve muzikore që dëgjojnë.			
Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta) Më pas, mësuesi/ja u vendos dy vepra muzikore nga kompozitorët Lorenca Antoni dhe Tonin Harapi. Nxënësit dëgjojnë fillimisht dy fragmentet dhe diskutojnë lidhur me muzikën. ▪ Fragment nga “Ç”janë këta krushq” korale, L. Antoni. ▪ “Trëndafili i vogël”, pjesë për piano T. Harapi. Pas diskutimeve që bëjnë rreth dy veprave muzikore, përjetimin që u jep muzika e dëgjuar, nxënësit e zhvillojnë përmes arteve të tjera.			
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore: (10 minuta) Përsëritin njohuritë e marra për emocionin dhe përjetimin në muzikë.			
Vlerësimi i nxënësve: Është demonstrimi i rezultateve të arritura të nxënësve në: N2: identifikimin nëpërmjet dëgjimit të llojit të muzikës, duke shpjeguar si është ajo: <i>e shpejtë, e ëmbël, e gëzueshme, e fortë</i> ; N3: dëgjimin dhe përcaktimin e llojit të muzikës që dëgjon; N3: përjetimin nëpërmjet arteve të tjera (vizatimit), emocionin që i jep muzika; N4: krahasimin dhe diskutimin e ndryshimit të llojit të muzikës që dëgjon sipas emocioneve që i shkaktohen.			
Detyrat dhe puna e pavarur Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë muzikë të llojeve të ndryshme dhe të shprehën emocionalisht rreth asaj që dëgjojnë.			

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (përjetimin emocional rreth muzikës që dëgjojnë).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor	Rezultati i të nxëniet të temës:		
Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike	Identifikon dukuritë muzikore ritmike e melodike, në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjuara.		

Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

III.2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxëniet.

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

RNF2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shenjat e ngjyrimit

Fjalët kyçe: shenja ngjyrimi, p, f, mf.

Rezultati/et e të nxëniet për orën mësimore**Nxënësi/ja:**

- identifikon mënyrën e luajtjes në instrument apo të këndimit *pianoforte*;
- përshkruan veprën muzikore që dëgjon, duke përdorur terminologjinë mbi shenjat e ngjyrimit;
- shpjegon kuptimin e shenjave të ngjyrimit gjatë përdorimit të tyre në muzikë;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (10 minuta)**

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet dëgjimit të një fragmenti të shkëputur nga pjesa muzikore “Nina nana” të kompozitorit J. Brahms dhe nxiten nxënësit të flasin rreth asaj që dëgjojnë. Pritet që ata të përshkruajnë me fjalët e tyre këngën.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Shpjegohen *shenjat e ngjyrimit*. Gjatë ekzekutimit të një vepre muzikore, ne themi këndoi fort këngën, ose butë. Një nga cilësitë e tingullit është i *fortë* - i *butë*, karakteristikë e cila tregon ose shpreh shkallën e forcës shprehëse ose të ëmbëlsisë që u jepet tingujve të një pjese muzikore. Në muzikë, ndryshe i quajmë shenja ngjyrimi dhe ato janë simbole ndërkombëtare. Shenjat e ngjyrimit dhe **lexohen** dhe **shkruhen** si më poshtë:

p-piano (i lehtë);

mf-mexoforte (gjysmë i fortë);

f-forte (i fortë).

Vazhdohet me një veprimtari dëgjimore.

Dëgjo këngën “Nina-Nana” të F. Schubert, dhe këngën “Tring zilja” të L. Dizdarit.

Shëno me $\sqrt{}$ cila këngë këndohet **lehtë** dhe cila këngë këndohet **fort**.

Nxënësit diskutojnë rreth plotësimit që kanë bërë me njëri-tjetrin.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore: (10 minuta)

Përse përdorëshin shenjat e ngjyrimit?

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: identifikimin e forcës së shprehjes së tingujve në një melodi apo vepër muzikore *piano/forte*;

N3: përshkrimin e një melodie që dëgjon, duke përdorur terminologjinë mbi shenjat e ngjyrimit;

N4: shpjegimin e shenjave të ngjyrimit, si dhe funksionimin e tyre në muzikë.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të krijojnë modele të tjera ritmike me katër goditje.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Rezultati i të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. II. 3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III. 5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 1. Nxënësi/ja merr pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Kënga “Të falim dashuri”	
Fjalët kyçe: teksti i këngës, melodi, interpretim.	
Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore	
Nxënësi/ja: - këndon këngën në ritëm dhe intonacion; - përjeton tekstin dhe muzikën e këngës, duke interpretuar me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.	
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:	
Fusha: Shoqëria dhe mjedisi Përdorimi në jetën e përditshme të koncepteve “libër”, “shok/shoqe”, “dashuri”.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:	
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit, duke u kërkuar atyre të tregojnë titullin e librit të fundit që ata kanë lexuar. I diskutojnë ato me njëri-tjetrin.	
Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta) Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Të falim dashuri”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënësve. Kujtohen rregullat e këndimit.	
Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet: - dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD; - procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga); - demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën; - këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD – me vesh nga nxënësit; - mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral; - mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim; - interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë; - këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram; - përvetësimi i këngës: <i>Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave;</i> - përkryerja artistike e këngës: <i>Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.</i>	
Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.	

I

Në raftin e babit libra shumë
gjeta një libër që fliste si un’.
Nuk e besova, mendova se po
ëndërroj,
kur, papritur, libri filloi të
këndoje.
E hapa me shpejt’ si,
sa shumë gjëra kishte aty,
përralla për fëmij’,
plot histori.
Por një gjë më ra në sy,
ishte si një porosi,
që sa më shumë
të falim dashuri.

Refreni

Libri im është dhe libri yt,
është për ne të gjithë,
na bën të duhemi më shumë
çdo ditë.
E lexoj, lexoj dhe për ty,
vlen për çdo njeri,
dhe na bën ta shohim botën
me tjetër sy.
Një botë për të gjithë
të falim dashuri.
E hapa me shpejtësi...

Refreni

Libri im është dhe libri yt,
është për ne të gjithë...

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)

Nxënësit:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth interpretimit solo dhe në grup;
- shpjegojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

Vlerësimi

Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:

N2: këndimin e këngës me të tjerët;

N3: interpretimin e këngës, me ndjenjë dhe emocion;

N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor;

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyrat dhe puna e pavarurUdhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Lojëra muzikore		Rezultati i të nxënit të temës: Luan lojëra të thjeshta muzikore të shoqëruara me këngë, të cilat kanë gjuhën shprehëse të përshtatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjella me lëvizje trupore, e me vegla muzikore fëmijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor etj.). Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. II. 3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III. 5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 1. Nxënësi/ja merr pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vallëzojmë me muzikën			
Fjalët kyçe: teksti i këngës, melodi, interpretim			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - kupton rregullat e grupit gjatë kërcimit; - zbaton rregullat e kërcimit dhe elementet bazë të tij, duke respektuar ritmin dhe muzikën; - bashkëpunon dhe bashkëvepron me grupin e kërcimit.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Edukimi fizik Kuptimi dhe përdorimi lojërave të ndryshme. Rëndësia e unifikimit të lëvizjeve me grupin dhe muzikën.
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (15 minuta) Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një veprimtarie gjithëpërfshirëse, ku mësuesi/ja ndan në tri grupe klasën dhe iu kërkon nxënësve të diskutojnë rreth disa pyetjeve që ju paraqitet. Një nxënës përfaqëson grupin me përgjigjet. <i>Për të vallëzuar bukur, duhet të zgjedhësh këngën apo melodinë që të pëlqen të vallëzosh.</i> <i>Të pëlqen të kërcesh muzikë:</i> • klasike • popullore • moderne <i>Diskuto me shokët dhe shoqet e klasës për këngën ose melodinë që zgjedhe për të kërcyer.</i> <i>Pse të pëlqen kjo këngë ose melodi?</i> <i>A përkohet lëvizjet e trupit me ritmin e melodisë që zgjedhe? Po Jo</i>
Ndërtimi i njohurive të reja (15 minuta) Vazhdohet puna me <i>konkursin</i> ku të tria grupet do të performojnë kërcimin e tyre të preferuar. • Grupet do të kërcëjnë melodinë 1, 2 apo 3, sipas shortit që iu bie. • Pjesëtarët e grupeve të vallëzimit shkëmbehen dhe shkojnë te grupi me melodinë apo kërcimin e preferuar dhe interpretojnë nga fillimi. • Në fund, grupi i jurisë vlerëson grupin më të mirë të kërcimit, si dhe valltarin ose valltaren më të talentuar.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (15 minuta) Nxënësit: - diskutojnë me njëri-tjetrin rreth kërcimit në grup dhe performimit më të mirë, duke vlerësuar grupin e vet dhe grupet e tjera.
Vlerësimi i nxënësit: Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në: N2: kuptimin e rregullave të kërcimit në grup; N3: zbatimin e rregullave gjatë kërcimit dhe elementet bazë të tij, duke respektuar ritmin dhe muzikën; N4: bashkëpunimin dhe bashkëveprimin me grupin e kërcimit.
Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit për dëgjimin (disa herë të këngës-lojë) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Artet dhe shoqëria Tema: Instrumentet muzikore		Rezultati i të nxënësve të temës: Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale ricikluese dhe organike (marakas me oriz, misër, da-jre të vogla etj.). Dallon instrumentet për nga materiali ndërtues, burimi tingëllor (instrumente të drunjtë, të tunxhit, frymore me harqe etj.), mënyra e interpretimit, ansambleve që u përkasin etj.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I. 9 Inicimi i veprimeve konstruktive.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF3. Nxënësi/ja dallon relacionet e ndryshme midis arteve dhe shoqërisë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Ndërtojmë instrumente muzikore			
Fjalët kyçe: instrument muzikor, materiale të riciklueshme, mjete pune.			
Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore Nxënësi/ja: - ndërton instrumentin muzikor, duke shpjeguar rrugën që ndoqi; - luan me instrumentin muzikor të ndërtuar; - shoqëron me instrumentin e krijuar këngë dhe lojëra muzikore, vetëm dhe me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Arte, Edukatë figurative Përdorimi i materialeve të riciklueshme në jetën e përditshme dhe konkretisht në ndërtimin e një instrumenti muzikor.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet prezantimit të disa materialeve të riciklueshme që do të përdoren për ndërtimin e instrumentit muzikor si tamburi, shkopinjë dhe trekëndëshi. Mësuesi/ja vendos mbi tavolinë <i>tamburi, shkopinjë dhe trekëndëshi</i> dhe pyet nxënësit nga se përbëhen ato. Ata provojnë tingëllimin e tyre, prekin dhe kuptojnë përbërjen dhe materialin me të cilin janë ndërtuar.			
Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta) Nxënësit fillojnë të ndërtojnë instrumentin e preferuar. Pasi kanë mbaruar ndërtimin e instrumentit, luajnë me to duke shoqëruar një këngë të mësuar më parë.			
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore: (10 minuta) Nxënësit bëjnë përfundimin e njohurive të marra duke diskutuar në lidhje me punën dhe rezultatin e arritur në krijimin e instrumentit të tyre muzikor.			

Vlerësimi i nxënësit: Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në: N2: ndërtimin e instrumentit muzikor, duke shpjeguar rrugën që ndoqi; N3: luajtjen me instrumentin muzikor të ritmeve të ndryshme me dy goditje; N4: shoqërimin me instrumentin e krijuar të këngëve dhe lojërave muzikore vetëm dhe me të tjerët.
Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit të ndërtojnë me materiale të riciklueshme instrumente të thjeshta fëmijore.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4 (katërt)
Konceptet: Artet dhe shoqëria Tema: Krijues dhe interpretues		Rezultati i të nxënës të temës: Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistike botërore dhe lokale	
Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF3. Nxënësi/ja dallon relacionet e ndryshme midis arteve dhe shoqërisë.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Muzikantë të shquar shqiptarë			
Fjalët kyçe: përjetim emocional, dëgjim muzikor.			
Rezultati/et e të nxënës për orën mësimore Nxënësi/ja: - identifikon llojin e muzikës gjatë dëgjimit; - përshkruan përjetimin e muzikës së populllore, klasike, moderne sipas emocioneve që ajo i krijon; - shpreh emocionet për muzikën që dëgjon përmes arteve të tjera si: vizatimi, lëvizjet trupore etj.; - respekton mendimin dhe gjykimet e të tjerëve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve – Diagrami i Venit (5 minuta) Ora mësimore nis nëpërmjet veprimtarisë muzikore dëgjimit me 2-3 fragmente muzikore, duke i nxitur nxënësit të flasin rreth muzikës së tyre të parapëlqyer. Ata dëgjojnë dhe respektojnë me njëri-tjetrin gjatë diskutimeve dhe gjejnë të përbashkëtat dhe të veçantat e fragmenteve muzikore që dëgjojnë.			
Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta) Më pas, mësuesi/ja u vendos dy vepra muzikore nga kompozitorët Lorenca Antoni dhe Tonin Harapi. Nxënësit dëgjojnë fillimisht dy fragmentet dhe diskutojnë lidhur me muzikën: ▪ “Peizazh”, L. Dizdari; ▪ “Ngadhënjim i madh”, B. Shehu. Pas diskutimeve që bëjnë rreth dy veprave muzikore, përjetimin që u jep muzika e dëgjuar, nxënësit e zhvillojnë përmes arteve të tjera.			
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore: (10 minuta) Përsëritin njohuritë e marra mbi emocionin dhe përjetimin në muzikë.			

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrimi i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: identifikimin nëpërmjet dëgjimit të llojit të muzikës, duke shpjeguar si është ajo *e shpejtë, e ëmbël, e gëzueshme, e fortë*;

N3: dëgjimin dhe përcaktimin e llojit të muzikës që dëgjojnë;

N3: përjetimin nëpërmjet arteve të tjera (vizatimit), emocionin që u jep muzika;

N4: krahasimin dhe diskutimin e ndryshimit të llojit të muzikës që dëgjojnë, sipas emocioneve që u shkaktohen.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë muzikë të llojeve të ndryshme dhe shprehen emocionalisht rreth asaj që dëgjojnë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4 (katërt)
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike		Rezultati i të nxënësve të temës: Përjeton dhe dallon dy dhe tre pjesëshmërinë në këngët e kënduara. Krijon melodi të thjeshta (me zë dhe instrumente muzikore) në formën 2 dhe 3 pjesore të këngës.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III. 2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënësve. III. 4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.			
RNF2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kënga 1-2 - 3 pjesëshe

Fjalët kyçe: kënga 1-2 pjesore, formë muzikore.

Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- kupton konceptin e formës muzikore të këngës për fëmijë;
- këndon këngën njëpjesëshe dhe dypjesëshe;
- gjen dhe shpjegon formën 1-2-pjesëshe.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Artet "Edukatë figurative"

Përdorimi i koncepteve të formës në vizatimin e formave të ndryshme që shikon në jetën e përditshme.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Mësimi fillon me një veprimtari (**konkrete**) me nxënësit, ku mësuesi/ja iu kërkon nxënësve të sjellin ndërmend këngën këngët “Gjuha e kafshëve”, “Ding-dong” dhe “Zilja e shkollës”. Sa strofa ka kënga? Po refrene?

Diskutohet me shokët e klasës.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

- Kur kënga përbëhet melodikisht vetëm nga **strofa**, quhet këngë njëpjesëshe. (A)

Forma njëpjesëshe (A)

A
I
Ciu-ciu-ciu, o zog i vogël,
Ciu-ciu-ciu, qan apo këndon?
Ciu-ciu, flas me nënën time,
Nëna, gjuhën ma kupton.

- Kur kënga përbëhet melodikisht nga **strofa dhe refreni**, këngë dypjesëshe.

Forma dypjesëshe (AB)

A **B**
I Refreni
Ding-dong, ding-ding-dong, U hap shkolla me shëndet
zilja jonë po na fton! dhe në klasë na thërret.

A



Ding-dong, ding-ding-dong, zi-lja jo-në po na fton! Po na fton!

B



U hap shkolla me shëndet dhe në klasë na thërret. Na thërret.

Më pas, **mësuesi/ja** i nxit fëmijët të ngjyrosin veprat e artit që janë vepra dy dhe tredimensionale.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)

Nxënësit:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth këngëve për fëmijë dhe formave që ato kanë në muzikë.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:

N2: kuptimin e konceptit të formës muzikore të këngët për fëmijë;

N3: këndimin e këngëve njëpjesëshe dhe dypjesëshe;

N4: gjetjen dhe shpjegimin e formës 1-2-pjesëshe.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** dhe përcaktimin e këngëve 1-2-pjesëshe.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. II. 3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III. 5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 1. Nxënësi/ja merr pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Këngë “Dua të gëzoj”			
Fjalët kyçe: teksti i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - këndon këngën në ritëm dhe intonacion; - përjeton tekstin dhe muzikën e këngës, duke interpretuar me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi Përdorimi në jetën e përditshme të koncepteve “festë, ditëlindje, 7 - 8 marsi etj ”.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Mësimi fillon me një veprimtari (<i>Brainstorming</i>) me nxënësit, duke shkruar në dërrasë fjalën Festa dhe duke u kërkuar të tregojnë çfarë u vjen në mendje lidhur me këtë fjalë. I diskutojnë ato me njëri-tjetrin.			
Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta) Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Dua të gëzoj”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit. Kujtohen rregullat e këndimit.			

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD;
- procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- demonstrimi i këngës nga mësuesi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD – me vesh nga nxënësit;
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral;
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi me të mëdha, këndimi i të gjitha strofave;*
- përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

- I -

Dua si një zog, unë të fluturoj,
këngët e gëzimit për ju t'i këndoj.
Dua të gjithë botën ta shoh veç me ngjyra
dhe të gjithë njerëzve t'u qeshë fytyra.

- Refreni -

Sa e lumtur jam unë e shokët e mi
kur mësuesja jonë na fal dashuri,
dhe kur prindërit qeshin e janë të gëzuar,
unë porsia flutur, lodroj pa pushuar.

II

Dua për çdo ditë të luaj, të qesh,
çdo njeri që unë shoh të më buzëqesh!
Sytë e egërsuar përherë më trishtojnë
dhe zemrën e vogël ata më lëndojnë.

- Refreni -

Sa e lumtur jam...

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)

Nxënësit:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth personazhit festat në familje, shkollë, me njëri-tjetrin.
- u shpjegojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

Vlerësimi

Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:

N2: këndimin e këngës me të tjerët;

N3: interpretimin e këngës, me ndjenjë dhe emocion;

N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor;


N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: IV
Konceptet: Artet dhe shoqëria Tema: Instrumentet muzikore		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon ngjyrën tingëllore të instrumenteve muzikore (popullore dhe klasike), përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshtatshme për moshën e tyre. Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht, sipas formës, madhësisë, ngjyrës etj. Dallon instrumentet për nga materiali ndërtues, burimi tingëllor (instrumente të drunjtë, të tunxhit, frymore me harqe etj.), mënyra e interpretimit, ansambleve që u përkasin etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF3. Nxënësi/ja dallon relacionet e ndryshme midis arteve dhe shoqërisë.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Instrumentet popullore			
Fjalët kyçe: dajre, çifteli, fyell, daulle, sharkia, lahuta etj.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: - kupton rolin e instrumenteve popullore në shoqërimin e muzikës; - shpjegon materialin, tingëllimin e instrumentit popullor dhe mënyrën e përdorimit; - klasifikon instrumentet popullore sipas prodhimit të tingullit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Identiteti kombëtar.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet diskutimit , ku mësuesi/ja kërkon të vëzhgojnë fotot në libër dhe flasin për atë instrument që njohin më mirë.			
Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta) Mësimdhënësi u shpjegon instrumentet popullore, duke i bërë edhe klasifikimin e tyre. Klasifikimi bëhet në bazë të prodhimit të tingullit që ato lëshojnë. Ato i ndajmë në:			

Instrumente që e prodhojnë tingullin nëpërmjet trysnisë së **ajrit** (frymës), si: *fyelli, gajdja, curlja, pipëza, zumarja* etj.




fyell



curlë

Instrumente që e prodhojnë tingullin përmes dridhjeve të **e kordave** (telave), si: *lahuta, çiftelia, sharkia, mandolina* etj.



lahutë




sharki

Instrumente që e prodhojnë tingullin nga **dridhjet e lëkurës**, si: *lodra, dajreja, qypi* etj.



dajre



daulle

Instrumente që e prodhojnë tingullin nga **përplasja ose fërkimi** i gurëve ose shkopinjve, tundja e zileve ose këmborëve etj.



këmborë



shkopinj

Më pas, ata provojnë veten duke zhvilluar ushtrimin në tekst.

Vëzhgo fotot e mëposhtme dhe përcakto grupin ku bën pjesë instrumenti popullor.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet popullore, duke diskutuar me ata:

- Ku ndryshon pamja e instrumenteve popullore?
- Çfarë tingulli lëshojnë ato?
- Ku ndryshojnë ato nga njëri-tjetri?

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

- N2: kuptimin e rolit që kanë instrumentet popullore në shoqërimin e muzikës;
- N3: shpjegimin e materialit dhe tingëllimit të instrumenteve popullore;
- N4: klasifikimin e instrumenteve popullore sipas prodhimit të tingullit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të vazhdojnë punimin e tyre në shtëpi.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Artet dhe shoqëria Tema: Krijues dhe performues		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistike botërore dhe lokale	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): I. 3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I. 9 Inicimi i veprimeve konstruktive.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF3. Nxënësi/ja dallon relacionet e ndryshme midis arteve dhe shoqërisë.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kompozitorë të njohur			
Fjalët kyçe: përjetim, dëgjim muzikor.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja:			
- dëgjon dhe përcakton llojin muzikor që luhet kënga apo pjesa muzikore <i>popullore apo klasike</i>; - përjeton nëpërmjet arteve të tjera emocionin që i jep muzika; - krahason dhe përshkruan ndryshimin e muzikës sipas emocioneve që i shkaktohen.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha Arte: Edukatë figurative Përdorimi i koncepteve figurative (si ngjyrat, vija dhe forma) në realizimin e përjetimit muzikor nëpërmjet ngjyrosjes apo vizatimit.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (10 minuta) Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese, ku mësuesi/ja u kërkon nxënësve të flasin rreth muzikës popullore. Dëgjim: “Kur ta ktheva Kosovë shpinën, e lamë borë e dimën”.			
Veprimtaritë e radhës (30 minuta) Më pas vazhdohet me ngjyrosjen e lahutës, instrument popullor shqiptar. Vendosen për dëgjim dy fragmente për dëgjim, duke i ftuar nxënësit të diskutojnë rreth karakterit dhe shpejtësisë me të cilën ato ekzekutohen. Pjesët e vendosura nga kompozitorë botërore:			
• Franc Jozef Hajden; • Eduard Grig.			
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore: (5 minuta) Nxënësit bëjnë përfundimin e njohurive të marra duke diskutuar përjetimet muzikore nëpërmjet arteve të tjera dhe të shprehurit rreth asaj që ndiejnë për muzikën që dëgjuan.			
Vlerësimi i nxënësve: Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:			
N2: evidentimin e muzikës që u pëlqen më shumë;			
N3: përjetimin nëpërmjet arteve të tjera (vizatimit) të emocionit që u jep muzika;			
N4: krahasimin dhe diskutimin e ndryshimit të muzikës sipas emocioneve që u shkaktohen.			
Detyrat dhe puna e pavarur			
Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë muzikë të llojeve të ndryshme dhe shprehën emocionalisht rreth asaj që dëgjojnë.			

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksioneve të mësimeve dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): I. 9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. II. 3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III. 5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 1. Nxënësi/ja merr pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Këngë “Një, dy, tre sonte erdhëm ne”			
Fjalët kyçe: teksti i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore Nxënësi/ja: - këndon këngën në ritëm dhe intonacion; - përjeton tekstin dhe muzikën e këngës, duke interpretuar me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve “atdhe”, “familje”, “dashuri”.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Mësimi fillon me një veprimtari (<i>Brainstorming</i>) me nxënësit, duke shkruar në dërrasë fjalën atdhe dhe duke u kërkuar të tregojnë çfarë u vjen në mendje lidhur me këtë fjalë. I diskutojnë ato me njëri-tjetrin.			

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “*Një, dy, tre, sonde erdhëm ne*”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënësve. Kujtohen rregullat e këndimit.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD;
- procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD – me vesh nga nxënësit;
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral;
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave;*
- përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)

Nxënësit:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth interpretimit vetëm dhe në grup;
- shpjegojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

Vlerësimi

Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:

N2: këndimin e këngës me të tjerët;

N3: interpretimin e këngës, me ndjenje dhe emocion;

N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor;

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

I

Tokën shoh nënë re,
fluturoj me mall,
un' po kthehem në atdhe,
se jam lindur larg.

II

Erdha me gëzim
në atdheun tim,
se do flas në shqip,
siç ke folur ti Naim.

Refreni

Një, dy, tre
sonde erdhëm ne,
mami, un' edhe babi im
sa e lumtur jam n' atdhe,
ku un' shoh të buk'rin vendin
tim.

III

Rrugët mbushur plot
qenkan plot ndriçim,
nuk e njihja dot
sot qytetin tim.

IV

Zemra më troket
dhe një zë më flet
me shumë dashuri
sa mir' jam në Shqipëri.

Refreni

Një, dy, tre...

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Artet dhe shoqëria Tema: Instrumentet muzikore		Rezultati i të nxënësve të temës: Dallon instrumentet për nga materiali ndërtues, burimi tingëllor (instrumente të drunjtë, të tunxhit, frymore me harqe etj.).	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): I. 3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I. 9 Inicimi i veprimeve konstruktive.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 3. Nxënësi dallon relacionet e ndryshme në mes të arteve dhe shoqërisë			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ngjyros në instrument muzikor			
Fjalët kyçe: piano, tromba, kitara.			
Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore Nxënësi/ja: - kupton rolin e instrumenteve muzikore në shoqërimin e muzikës; - shpjegon materialin dhe tingëllimin e instrumentit; - ngjyros instrumentet muzikore; - përshkruan punimin e vet dhe të shokut.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet diskutimit, ku mësuesi/ja kërkon të vëzhgojnë fotot me instrumentet në libër dhe flasin për atë instrument që njohin më mirë.			
Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta) Ftohen nxënësit të ngjyrosin dhe njëkohësisht të flasin rreth punës së tyre.			
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore: (10 minuta) Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet në përgjithësi duke diskutuar me ata: - Ku ndryshon pamja e instrumenteve muzikore? - Çfarë tingulli lëshojnë ato? - Ku ndryshojnë ato nga njëri-tjetri?			
Vlerësimi i nxënësve: Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në: N2: kuptimin e rolit të instrumenteve muzikore në shoqërimin e këngëve dhe melodive; N3: shpjegimin e materialit, tingëllimin e instrumentit dhe mënyrën e përdorimit. N4: ngjyrosjen e instrumenteve muzikore.			
Detyrat dhe puna e pavarur			
Udhëzohen nxënësit të vazhdojnë punimin e tyre në shtëpi.			

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Artet dhe shoqëria Tema: Llojet e muzikës		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri, përmes dëgjimit muzikor (p.sh.: muzikë për vallëzim, muzikë për film, teatër, muzikë për fëmijë, muzikë për raste të ndryshme, muzikë festive etj.). Përzgjedh muzikën e përshtatshme për ngjarjet dhe situatat e ndryshme, shfaqjet në klasë, shkollë, komunitet etj. Përzgjedh muzikën e përshtatshme për poezitë dhe tregimet e ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I. 9 Inicimi i veprimeve konstruktive.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF3. Nxënësi/ja dallon relacionet e ndryshme midis arteve dhe shoqërisë.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Muzika dhe artet e tjera			
Fjalët kyçe: përjetim, dëgjim muzikor.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - identifikon nëpërmjet dëgjimit karakterin e melodisë që dëgjon <i>e trishtuar, e shpejtë, e ëmbël, e gëzueshme;</i> - dëgjon duke përcaktuar llojin muzikor që luhet kënga apo pjesa muzikore; - përjeton nëpërmjet arteve të tjera emocionin që i jep muzika; - krahason dhe përshkruan ndryshimin e muzikës sipas emocioneve që i shkaktohen.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha Arte: Edukatë figurative Përdorimi i koncepteve figurative (si ngjyrat, vija dhe forma) në realizimin e përjetimit muzikor nëpërmjet ngjyrosjes apo vizatimit.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese, ku mësuesi/ja u kërkon nxënësve të flasin rreth muzikës apo një kompozitori që ata njohin më mirë.			
Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta) Më pas, vazhdohet me vendosjen për dëgjim të disa fragmenteve muzikore. Vendosen 3 fragmente nga 3 vepra muzikore dhe nxiten nxënësit të diskutojnë rreth karakterit me të cilën ato ekzekutohen.			
Pjesët e vendosura nga kompozitorët: - “Vallëzimi i tarantelës”, Xhoakino Rosini; - “Vashës”, korale Akil Koci; - “Ajri”, Johan Sebastian Bah. Vijohet me veprimtarinë, ku nxënësit ftohen të vizatojnë duke u bazuar në përjetimet e tyre ndaj muzikës që dëgjojnë në sfond.			

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore: (10 minuta)

Nxënësit bëjnë përfundimin e njohurive të marra, duke diskutuar përjetimet muzikore nëpërmjet vizatimit dhe të shprehurit rreth asaj që ndiejnë për muzikën që dëgjuan.

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: evidentimin e kompozitorit që i pëlqen më shumë nëpërmjet veprës muzikore;

N3: përjetimin nëpërmjet arteve të tjera (vizatimit), emocionin që i jep muzika;

N4: krahasimin dhe diskutimin në ndryshimin e muzikës sipas emocioneve që i shkaktohen.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë muzikë të llojeve të ndryshme dhe të shprehin emocionalisht rreth asaj që dëgjojnë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (përjetimin emocional rreth muzikës që dëgjojnë).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. II. 3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III. 5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 1. Nxënësi/ja merr pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Këngë “E dua kitarën”			
Fjalët kyçe: teksti i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - këndon këngën në ritëm dhe intonacion; - përjeton tekstin dhe muzikën e këngës, duke interpretuar me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve “kitara”, “profesion”, “dëshirë”.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)

Mësimi fillon me një veprimtari (**Brainstorming**) me nxënësit, duke shkruar në dërrasë fjalën **kitara** dhe duke u kërkuar atyre të tregojnë çfarë ju vjen në mendje lidhur me këtë fjalë.

I diskutojnë ato me njëri-tjetrin.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vazhdohet puna me mësimin e këngës “E dua kitarën”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënësit. Kujtohen rregullat e këndimit.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD;
- procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD – me vesh nga nxënësit;
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral;
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave;*
- përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempë përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)

Nxënësit:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth instrumenteve muzikore;
- shpjegojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

Vlerësimi

Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:

N2: këndimin e këngës me të tjerët;

N3: interpretimin e këngës, me ndjenjë dhe emocion;

N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor;

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

I

Ngado që të shkoj,
ngado që të vij',
Tingujt e kitarës
më sjellin k'naqsi.

Refreni

E dua kitarën
prandaj e mësoj,
të bëhem kitariste
vërtet shumë dëshiroj.

II

Me kitarën time
luaj e këndoj,
e dua me zemër
shumë e adhuroj.

Refreni

E dua kitarën
prandaj e mësoj,
të bëhem kitariste
vërtet shumë dëshiroj.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: IV
Konceptet: Artet dhe shoqëria Tema: Instrumentet muzikore		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon ngjyrën tingëllore të instrumenteve muzikore (popullore dhe klasike), përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshtatshme për moshën e tyre. Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht, sipas formës, madhësisë, ngjyrës etj.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

RNF3. Nxënësi/ja dallon relacionet e ndryshme midis arteve dhe shoqërisë.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Njësia mësimore:** Tastiera**Fjalët kyçe:** piano.**Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:****Nxënësi/ja:**

- njihet me instrumentin e tastierës;
- demonstroi vendosjen e dy duarve në tastierë;
- luajti notave muzikore me dy duar.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4.**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:****PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**

Ora mësimore fillon duke bërë prezantimin e **tastierës**, ku mësuesi/ja u kërkon të vëzhgojnë tastierën/pianon, duke folur për këtë instrument.


Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Mësimdhënësi/ja u shpjegon si luhet në tastierë.


Dora e djathtë shërben për të luajtur melodinë, ndërsa **dora e majtë** për ta shoqëruar atë.

Gishtat duhet të jenë në formë gjysmë harku, por jo të shtrenguar. Puls i dorës dhe krahu duhet të jenë të lirshëm.

Çdo gisht i dorës së majtë apo të djathtë ka një numër me të cilin do të orientoheni gjatë luajtjes në piano.



Nxënësit fillojnë të provojnë të luajnë në tastierë.



Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: praktikimin në instrumentin e tastierës me një dorë;

N3: praktikimin në instrumentin e tastierës me dy duar;

N4: luajtjen e notave muzikore me dy duar.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të vazhdojnë ushtrimin në tastierë në shtëpi.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa:
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Krijim muzikor		Rezultati i të nxënit të temës: Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike. Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëgjëzat etj. Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-përgjigje muzikore etj.). Këndon ose luan në instrumente fëmijërore ndonjë krijim origjinal të shkurtër (ritmik, melodik) me inkurajimin dhe ndihmën e mësimeve.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënit. III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 1. Nxënësi/ja merr pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Njësia mësimore:** Krijojmë dhe këndojmë**Fjalët kyçe:** ritëm, model ritmik, plotësim muzikor.**Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore****Nxënësi/ja:**

- plotëson modele ritmike në ritmin 2/4;
- zhvillon ushtrimet muzikore duke i plotësuar ato;
- luan në instrument një melodi të thjeshtë muzikore;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4.**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:****PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (10 minuta)**

Ora mësimore fillon me leximin e **një vjershe të vogël**. Mësuesi/ja përcakton 7 nxënës që do të përfaqësojnë çdo notë muzikore.

Unë jam **DO**-ja, nota e par',
 që i udhëheq të gjitha mbar'.
 Jam e dyta unë pas **DO**-së,
 emrin **RE** të gjith' ma thon'.
 Mi e treta jam dhe un',
 në vijë, aty lë gjurm'.
 Shpesh me vijat më ngat'rrojn',

FA në fush' duhet t'më shënojn'.
 Ej, ju miq nuk kemi mbaruar!
 Un' jam e pesta, **SOL** më quajn'.
 Jam e gjashta, mos u mërzisni,
LA do t'më thërrisni.
 Ja dhe **SI**-ja, pa dyshim,
 mbyll shtatë notat, që tashmë i dim'.

Vazhdohet më tej me tri veprimtari të tjera ku nxënësit plotësojnë mbi modelet e dhëna dhe luajtjen në instrumentin e tastierës. **(30 minuta)**

Shembulli 1: **Shkruan** notën dhe shkronjën e alfabetit muzikor në pentagram dhe kutitë bosh.



Shembulli 2: **Emërto** notat muzikore në ushtrimin e mëposhtëm.



Shembulli 3: **Luaj** në ksilofon ose në tastierë vijën melodike.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore: *Bashkëbisedim (5 minuta)*

U kërkohet nxënësve të diskutojnë lidhur me krijimet dhe plotësimet muzikore.

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: plotësimin e modeleve dhe ushtrimeve në tekst;

N3: zhvillimin e ushtrimeve muzikore duke i plotësuar ato;

N4: luajtjen në instrument një melodi të thjeshtë muzikore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit të krijojnë ushtrime të reja në shtëpi.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Rezultati i të nxënësve të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik(grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë këndimit të këngës. II. 3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III. 5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.			

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

RNF 1. Nxënësi merr pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kënga “Kënga ime”

Fjalët kyçe: teksti i këngës, melodi, interpretim.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore**Nxënësi/ja:**

- diskuton lidhur me tekstin e këngës dhe melodinë;
- këndon këngën ritmiksht dhe melodiksht;
- interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion;
- këndon vetëm dhe në kor/grup.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi dhe artet

Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme “shqiptar”, “gjuha shqipe”.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet *Brainstorming*, ku mësuesi/ja vendos foton e Shqipërisë dhe Kosovës. Ai nxit nxënësit duke drejtuar pyetjen: Çfarë ju sjellin në mend fotot që shikoni? Flisni rreth tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD;
- procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- demonstrimi i këngës nga mësimgjithmërisë për të mësuar këngën;
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD – me vesh nga nxënësit;
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral;
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave;*
- interpretimi artistik i këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempa përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Reflektimi (10 minuta)

Përsëritja e këngës “Kënga ime” dhe diskutimi rreth melodisë dhe tekstit.

I

Kënga ime, sa e ëmbël, atje larg jehon,
zemrat e vogëlushve i pushton.
Bukur fjalën shqipe nëna ime ma mësoi,
gjith' jetën un' do ta këndo.

II

T'fala ka nga zemra ime dhe nga vendi im,
bukurin' e shqipes kënga zgjon.
I gëzoi fëmij't e botës fyelli i vendit tim,
malet edhe detet i mbuloi.

Refreni

Ne s'bashku botës shqip le t'i këndojm',
kënga jon' gazmore kudo të jehoj'.
Un' me ju do të krenohem se jam shqiptar,
melodin' e bukur shqipes do t'çoj an'e mban',
shpirtin ton' melodinë do t'çoj an'e mban'.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve për:

- këndimin e këngës pa gabime dhe me diksion të qartë;
- këndimin e këngës saktë ritmikiisht dhe melodikiisht;
- interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;
- interpretimin e këngës vetëm dhe në kor/grup.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke i lidhur njohuritë e tyre me temën e re dhe këndimi i këngës me ndjenjë dhe emocione, duke shoqëruar me lëvizje trupore.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Çmuarja dhe vlerësimi estetik dhe artistik Tema: Ngjarje artistike		Rezultati i të nxënit të temës: Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjate bisedës dhe vrojtimit , me lëvizje,mimike, me mjete shprehëse te tjera artistike etj. Përshkruan dhe komenton (me forma të ndryshme shprehëse: me gojë, me shkrim, me shprehje figurative, etj) ndonjë ngjarje muzikore artistike të përjetuar në familje, në shkollë, koncert, nga TV etj	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 4. Nxënësit mësojnë të çmojnë dhe vlerësojnë artin.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ngjarje artistike			
Fjalët kyçe: koncert, shfaqje.			

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: - flet rreth ngjarjeve muzikore që kanë ndodhur në qytetin apo krahinën e vet; - merr pjesë në ngjarje të ndryshme artistike muzikore lokale apo kombëtare; - grumbullon material për ngjarje muzikore të zhvilluara në qytetin e vet; - ndan njohuritë e veta me të tjerët.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Edukatë muzikore 4, mjete të tjera për të punuar.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (10 minuta) Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese përmes <i>Brainstorming</i> (foto/postera/filmime), ku mësuesi/ja nxit nxënësit të flasin në lidhje me ngjarje muzikore brenda dhe jashtë vendit ku ata kanë marrë pjesë apo kanë parë. Nxënësit nxiten të diskutojnë në lidhje me të dhe dëgjojnë mendimin e njëritjetrit. Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta) Më pas, jepen disa aktivitete muzikore të kryera në Kosovë dhe Shqipëri dhe nxënësit gjejnë në hartë qytetin ku është kryer aktiviteti. Ata zgjerojnë më shumë diskutimin lidhur me ngjarjen, qytetin etj. Ata vizatojnë ndërtesën ku jepen shfaqjet artistike në qytetin apo krahinën e tyre. Nxënësit nxiten për kërkimin dhe gjetjen e informacioneve shtesë mbi ngjarje muzikore që ju kanë lënë mbresa nga <i>interneti</i>, dhe sjellin prezantimin e tyre në klasë. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta) Përsëritin njohuritë e marra mbi ngjarjet artistike.
Vlerësimi i nxënësve: Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në: N2: përshkrimin e ngjarjeve muzikore që kanë ndodhur në qytetin apo krahinën e vet; N3: shpjegimin e ngjarjeve të ndryshme artistike muzikore lokale apo kombëtare, duke veçuar karakteristikat e tyre; N4: grumbullimin e materialeve për ngjarje muzikore të zhvilluara në qytetin e vet.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë në zhanrin e tyre të parapëlqyer dhe krijojnë një punim të vetin.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Rezultati i të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik(grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. II. 3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III. 5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 1. Nxënësi/ja merr pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kënga “Një botë me mirësi”			
Fjalët kyçe: teksti i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - këndon këngën në ritëm dhe intonacion; - përjeton tekstin dhe muzikën e këngës, duke interpretuar me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi anglisht Përdorimi me lehtësi i gjuhëve të huaja, këndimi i këngëve në muzikë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Mësimi fillon me një veprimtari (Brainstorming) me nxënësit, duke shkruar në dërrasë fjalën: nënë dhe duke u kërkuar të flasin rreth saj. Ata diskutojnë me njëri-tjetrin.			
Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta) Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Një botë me mirësi”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit. Kujtohen rregullat e këndimit.			

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD;
- procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- demonstrimi i këngës nga mësuesi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD – me vesh nga nxënësit;
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral;
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- përveçimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave;*
- përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempa përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përveçimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)

Nxënësit:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth interpretimit vetëm dhe në grup;
- shpjegojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

Vlerësimi

Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:

N2: këndimin e këngës me të tjerët;

N3: interpretimin e këngës, me ndjenjë dhe emocion;

N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor;

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

I

Një vështrim në syt' e nënës
më flet,
më qorton pa fjalë.
Një rrudh' përmbi ball'
një merak më pret mbushur
plot me mall'.
Një dor' përmbi flok',
qiell' që portat hap,
ajo është vetëm Nëna.
Sjell një fjal' të ngrohtë
zjarr në dit' të ftohtë,
mij'ra diej në zemra.

Refreni

Më ndjek kudo sot zëri i
nënës.
Një melodi e rrallë,
kuptim merr jeta gjithmon'
me të,
e ndiej un' fare pranë.
Je mami im,
tu est mon mamo,
tu sei la mia mama!
Në të gjith' botën
mij'ra zëra njëlloj
thërrasin: mama!
Njëlloj thërrasin: mama!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: 4
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Këngët		Rezultati i të nxënësve të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimit instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore. II. 3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. III. 5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF 1. Nxënësi/ja merr pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kënga “Festa e këngës”			
Fjalët kyçe: teksti i këngës, melodi, interpretim.			
Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore Nxënësi/ja: - këndon këngën në ritëm dhe intonacion; - përjeton tekstin dhe muzikën e këngës, duke interpretuar me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 4, CD, magnetofon.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi anglisht Përdorimi me lehtësi i gjuhëve të huaja, këndimi i këngëve në muzikë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta) Mësimi fillon me një veprimtari (Brainstorming) me nxënësit, duke shkruar në dërrasë fjalën: festë dhe duke u kërkuar të flasin rreth saj. Ata diskutojnë me njëri-tjetrin.			
Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta) Vazhdohet puna me mësimin e këngës “Një botë me mirësi”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënësve. Kujtohen rregullat e këndimit.			

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD;
- procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);
- demonstrimi i këngës nga mësuesi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD – me vesh nga nxënësit;
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral;
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave;*
- përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)

Nxënësit:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth interpretimit vetëm dhe në grup;
- shpjegojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

Vlerësimi

Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:

N2: këndimin e këngës me të tjerët;

N3: interpretimin e këngës, me ndjenjë dhe emocion;

N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor;

N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

I

Ja tek po vjen Qershor' i ri
Vrapojm' të ngjitemi në sken'
Të gjith' fëmijët i pret kënga
Në zemër çelin me mijra
ëndrra.

II

Dëgjoen tinguj përsëri
Me ngjyra jete si ylber,
Aty ka qengja në lëndinë,
Ka lodra dhe mësim
Dhe përralla dhe lule pranver'
La, la.....

Refreni

Dhe rrjedhin tingujt si ujrart
Që nga mali burojnë
Si mblidhen lulet
Në fush' edhe në mal,
E bëhet këng'
Edhe këngët gjith' fëmijët
këndojnë.
Në Shkodrën tonë për çdo vit
Në festival.

Referenca

- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2011.
- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Kurrikula Bërthamë (Klasat 0, I, II, III, IV dhe V) (e rishikuar), 2016.
- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Plani dhe programi lëndor për klasën e katërt të arsimit fillor në Republikën e Kosovës (i rishikuar), 2020.
- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Udhëzues për zbatimin e kurrikulës për klasën përgatitore dhe arsimin e mesëm të ulët, 2014.

